



SHIKOJ.COM

Françesko JAKOMONI
(MËKËMBËSI I VIKTOR EMANUELIT III NË SHQIPËRI)

Politika e Italisë në Shqipëri

Përktheu: Kostaq XOXHA

HYRJE

VAZHDIMËSIA SHEKULLORE E MARRËDHËNIEVE ITALO-SHQIPTARE

Gjendja e vështirë ekonomike dhe politike e Shqipërisë në vitin 1926 – Pamundësia e qeverisë shqiptare për t'i bërë ballë kësaj gjendjeje, përmes Shoqërisë së Kombeve – Kthimi në atdhe, në fund të vitit 1924, i Ahmet Zogollit, përmes Jugosllavisë - Zgjedhja e tij si President i Republikës - Fataliteti i marrëdhënieve politike , ekonomike dhe kulturore, të lashta e të reja, e çojnë që t'i drejtohej Italisë për të forcuar Shtetin shqiptar - Nënshkrimi i një traktati të fshehtë - Origjina e Bankës Kombëtare të Shqipërisë dhe e "Shoqërisë për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë" (SVEA). Emërimi i baronit Aloizi si ministër i Italisë në Durrës.

Më 3 mars të vitit 1924 delegati shqiptar në Shoqërinë e Kombeve iu drejtua Këshillit për t'i kujtuar se Shqipëria ishte i vetmi shtet ballkanik që nuk kishte marrë nga jashtë asnjë mbështetje financiare, që nga fillimi i pavarësisë së tij. Delegati britanik në Gjenevë, lordi Parmur, dha mendimin e tij që Lidhja (e Kombeve, -p.), ta merrte parasysh këtë kërkesë, si një rast i dhimbshëm në të

cilin " ajo që të bënte përshtypje të veçantë, ishte dinjiteti, kuraja dhe nënështrimi i fatit me të cilin këta malësorë të shkretë kishin përballur fatin e tyre të ashpër. Ndër këta kishte të vdekur të shumtë nga uria, nga të ftohtit, nga varfëria, pa u qarë për këtë skamje. Nuk e ngritën kurrë zërin e nuk kërkuan ndonjëherë lëmoshë". U vendos që Lidhja të caktonte një shumë prej pesëdhjetë mijë frangash zvicerane. Me këtë ndihmë u ble grurë, por vetëm në tetor, që t'i ndahej popullit.

Nuk ishte hera e parë që qeveria shqiptare i kërkonte ndihmë Shoqërisë së Kombeve. Në prillin e vitit 1923, në zbatim të një vendimi të Këshillit, në majin e vitit 1922, kërkuar nga delegati shqiptar Mehdi Frashëri, kishte ardhur në Shqipëri një këshilltar financiar, hollandezi Hunger. Ky, duke vënë re se gjendja financiare shqiptare ishte tepër e rëndë, kishte dhënë mendimin që të krijohet një Bankë dhe e kishte këshilluar qeverinë shqiptare që të bënte kursime të forta. Përgjigjja e qeverisë shqiptare ishte denoncimi i vetë kontratës me zotin Hunger, rroga e të cilit ishte e para që parlamenti shqiptar e gjente të kundërshtueshme, si të papërpjesshme me burimet e vendit. Lirimi i këtij eksperti të Gjenevës ishte bërë i detyrueshëm më tepër jo për rrogën e tij të lartë, sesa për zhgënjimin që zgjoi në vend, meqë s'kishte mundur të arrinte dot marrjen nga ana e Shoqërisë së Kombeve një borxh për të cilin qeveria shqiptare kishte më shumë nevojë, sesa për këshillat e tij. Zhgënjimi shqiptar përkundrejt Shoqërisë së Kombeve duhej të kishte qenë me të vërtetë i rëndë, po të kemi parasysh se në mbledhjen e Shoqërisë së Kombeve të datës 10 shtator 1924, kryeministri i atëhershëm shqiptar, imzot Fan Noli, mendoj se i lejohej, tashmë, që të mbante një fjalë e cila, për vrullin e saj të zjarrtë, meriton të citohet në disa pjesë: -"Duke shqyrtuar veprimtarinë që ka bërë deri tani Lidhja e Kombeve, gjatë pesë viteve të jetës së saj aktive, unë them se edhe paqësorët më të përmbajtur, do të ngrinin duart drejt qiellit, në shenjë dëshpërimi... Ajo që është bërë gjatë këtyre pesë viteve, fle në paqe, në paqen e përjetshme, që është bashkëngjitur në mënyrë të përshtatshme në faqet e arkivave të sekretariatit".

Pak muaj më pas nga kjo mbledhje e Asamblesë, në të cilën

imzot Fan Noli kishte shprehur me aq hidhërim zhgënjimin ndaj Shoqërisë së Kombeve ndaj vendit të tij, ndodhi në Shqipëri diçka jashtëzakonisht e rëndësishme.

Ahmet Zogolli kishte hyrë në Shqipëri përmes Jugosllavisë. Ky ishte një bujar i ri i Matit, që kishte vepruar me energji të madhe, kur kishte pasë qenë ministër i Brendshëm, në qeverinë e formuar fill pas Luftës I Botërore, nga Kongresi i Lushnjes. Pastaj ishte larguar nga vendi, si pasojë e një kryengitjeje. – “Një revolucion në Shqipëri, - shkruante Mehmet Konica, që atëherë ishte ministri i Shqipërisë në Londër, - ishte diçka paksa më e ndryshme nga një zgjedhje politike në një vend me demokraci të lashtë. Revolucionet, - shtonte ai, - ishin mënyra me të cilat, në një vend në të cilin zgjedhjet nuk e shprehnin si duhet vullnetin e popullit, një pakicë kërkonte ta përmbyste parlamentin para mbarimit të legjislaturës, domethënë të rrëzonte shumicën që kishte humbur pëlqimin e popullit”.

Ahmet Zogolli, sapo mbërriti në Tiranë, i dërgoi një telegram të përzemërt markezit Duraco, përfaqësuesit diplomatik italian në Shqipëri. Sapo u zgjodh President i Republikës, ai i telegrafoi drejtpërdrejt kryetarit të qeverisë italiane, duke i shprehur besimin se ndihma morale e Italisë dhe mirëdashja e saj nuk do t'i mungonin Shqipërisë. Ndonëse ishte kthyer në Shqipëri nëpërmjet Jugosllavisë, Ahmet Zogolli kishte nevojë të ngutshme për mirëdashjen dhe për ndihmën italiane, që ishin një nevojë jetësore për Shqipërinë, që prej kohësh të vjetra.

Apollonia (Pojani i sotëm) dhe pastaj Epidamno, (sipas latinishtes: *Dyrrachium* dhe tani: Durrësi), qysh në vitin 229 para Krishtit kishin kërkuar ndihmën e romakëve për t'u mbrojtur nga veprimet e piraterisë. Prej më shumë se një mijë e pesëqind viteve, fatet e Shqipërisë ishin lidhur më parë me Romën dhe , pastaj , me këtë apo me atë qytet Italian.

Përgjatë Matit, në Shqipërinë Qendrore, kalonte kufiri që ndante perandorinë romake të Lindjes me atë të Perëndimit. Në njërin breg dhe në tjetrin të Adriatikut kishin zbritur pushtime barbare (të huaja,-p.) që shkatërronin dhe shkretënin civilizimin.

Me rënien e zotërimit bizantin, normani Robert Guiskardi, duke ia behur në Durrës nga mbretëria e tij napolitane i dha jetë dhe trajtë Shtetit të parë të njësuar (unitar) shqiptar, me anë të një shpalljeje që nxori në një Asamble të krerëve vendorë, që u mbajt në Durrës.

Normanët ishin të mbështetur nga mbreti i Napolit, nga anzhuinët dhe nga aragonezët. Pas rënies së fuqisë të mbretërve të Napolit, Durrësi kishte kërkuar mbrojtjen e Venedikut.

Kur, pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, Skënderbej, që kishte mbrojtur heroikisht civilizimin kristian në Ballkan, Osmanët nënshtruan, në mbarim të 1500-s të gjithë Shqipërinë, disa lidhje ndërmjet të dy brigjeve vijuan të mbeteshin të gjalla në mendësinë perëndimore me tregtinë ndërmjet Venedikut dhe Triestes, për hir të zotërimit të drejtpërdrejtë që Venediku ruajti me Pargën, me Butrintin dhe me Prevezën, gjer në traktatin e Kampoformios, të vitit 1797.

Në vitin 1582, gjatë një rëse prej të 52 kryengritjeve shqiptare kundër Otomanëve, kurora e Shqipërisë iu ofrua Karl Emanuelit I të Savojës. Edhe me Napolin nuk rështën kurrë tërësisht marrëdhëniet, aq sa vetë guvernatorët otomanë kishin lejuar në Shqipërinë jugore, rekrutimin e regjimentit të Maqedonisë i cili, në shërbim të mbretit të Napolit kishte pasur një ndihmesë të frytshme në betejën e Veletrit të vitit 1744, ku u mund nga napoletanët gjenerali austriak Lobkovic.

Në mbarim të pushtimit otoman treshekullor, gjatë kohës kur Italia kishte pasur një ndikim të rëndësishëm në Shqipëri, mjaft sundimtarë të fuqishëm italianë u dhanë strehim në tokat e tyre shumë mërgimtarëve shqiptarë. Ata që u vendosën në Republikën Veneciane, në Abruco dhe në Pulje, u përziën me popullatat vendore ilire, që ishin formuar fillimisht nga Japidët, Mesapët dhe nga Peucezët, që qenë në krushqi të ngushtë me banorët e brigjeve përballë dhe pjesa më e madhe e të mërguarve u përvetuan (u asimiluan). Kurse në Kalabri dhe në Sicili të mërguarit krijuan qendra bujqësore të përparuara dhe ruajtën gjuhën, zakonet dhe ritet fetare të atdheut të zanafillës (të origjinës). Nga këto popullsi,

të cilave u përkiste Françesko Krispi, që e quante veten shqiptar në gjak dhe nga zemra, nisën shtysat e kryengritjeve kundër zaptuesve otomanë, kryengritje të cilat në Shqipëri nuk u flashkën kurrë tërësisht. Madje bash nga këto bërthama më vonë u ngritën zëra me autoritet që të njëhej në kongrese ndërkombëtare e drejta e ligjshme e shqiptarëve që të kishin institucionet e një Shteti sovran. Buja që bëri poema "Milosao", epope e dhembjes kombëtare shqiptare dhe kryevepër e Jeronim De Radës, që kishte lindur në Makia të krahinës së Kozencës, një famë e tillë, pra, i kaloi kufijtë e Italisë. Kjo poemë zgjoi admirimin e francezëve të shquar, siç ishin Lamartini dhe Mistrali. Shkrimtarë të tjerë ndoqën shembullin e De Radës. Dhe pati një rëndësi të dorës së parë puna e Zef Skiroit, në dobi të historisë së vendit të tij. Skiroi kishte botuar libra dhe dokumente të vendit të tij, të cilat e ngritën çështjen shqiptare në sytë e Europës.

Së bashku me delegatin austro-hungarez Andrassy, Françesko Krispi ngri në Kongresin e Berlinit, në vitin 1878, çështjen shqiptare. Një dokumentim i argumentuar dhe regëtues i qëndrimit që ishte mbajtur nga klasat politike më të përgatitura italiane të kohës përkundërt Shqipërisë, mund të gjendet në letrat që iu dërguan "Gazetës së Italisë", në vitin 1902, nga markezi San Xhuliano nga Vlora, nga Shkodra dhe nga Janina.

Në vitin 1898 filloi botimin e saj gazeta "Kombi shqiptar". Titulli shprehte programin e saj. Në vitin 1903 u krijua në Itali një komitet i kryesuar nga Riçioti Garibaldi, për dërgimin e vullnetarëve në luftën kundër Turqisë, për pavarësinë e Shqipërisë. Një publik gjithnjë e më i gjerë filloi të interesohet në Itali për çështjen shqiptare. Në parlament kjo u bë objekt i diskutimeve të zjarrta nga ana e burrave më të shquar të Shtetit. Kur, në luftën kundër Turqisë (1911-'12), aleanca e katërfishtë ballkanike deshi të pushtojë troje të banuara nga shqiptarët, keta u mbrojtën me shpirtin në dhëmbë, por me tërbim. Arsyet e ligjshme të popullit shqiptar (*shqiptar*, - në origjinal, - p.), gjetën jehonë dhe mirëkuptim në Itali: Markezi San Xhuliano në Senat, nga tribuna qeveritare, pohoi jo vetëm nevojën e lindjes së një Shteti shqiptar, por edhe që këtij shteti "t'i

siguroheshin kufijtë dhe institucionet që mund të zhvillonte me qëllim që të përparonte”.

Lufta ballkanike dhe traktativat që pasuan atë luftë, ishin fusha në të cilën ministri San Xhuliano tregoi interesimin e tij për lindjen e një Shteti shqiptar jetësor (vital). Kërcënimi i një veprimi të drejtpërdrejtë nga ana e Austro-Hungarisë, zgjoi paralajmërimin e San Xhulianos se “marrëdhëniet italo-austriake, që u krijuan me mundim, do të prisheshin rëndë”. Më 17 dhjetor të vitit 1913, Konferenca e Asmbasadorëve, e ngarkuar që të vendoste kufijtë dhe organizimin politik-administrativ të principatës së re shqiptare, përfundoi punimet e saj në Firenze.

Erdhën vitet e Luftës I Botërore. Ngjarjet e luftës e çuan Italinë, pas pushtimit të Vlorës, në bazë të sigurisë që iu dha Shqipërisë, në vitin 1913 nga Konferenca e ambasadorëve, që italianët të vepronin të armatosur në të gjithë Shqipërinë e Jugut, me përjashtim të Korçës, që ishte pushtuar nga trupat franceze. Qëllimi që i kishte vënë vetes qeveria italiane ishin të përcaktuara në shpalljen e saj të 3 qershorit të vitit 1917 në Gjakastër nga gjenerali Ferrero, komandanti i trupave tona në Shqipëri. Shpallja pohonte solemnisht njësinë dhe pavarësinë e të gjithë Shqipërisë, nën mbrojtjen e Italisë. Vlera e kësaj shpalljeje u sqarua, pastaj, më 21 qershor 1917, para Dhomës së deputetëve nga ministri i Jashtëm, Sonino: “Ne mbrojmë pavarësinë e Shqipërisë, në përshtatje (në konformitet) me parimet e aleancave tona. Italia nuk ka qëllim tjetër ndaj Shqipërisë, veçse mbrojtjen përkundrajt çdo ndërhyrje të parashikueshme apo kërcënim nga Forca të treta”.

Më 13 shkurt 1918 deputeti Sonino përsëriti se fatet e Shqipërisë kërkonin një interesim të veçantë të Italisë, që ishte i ndërlidhur jo vetëm me sigurinë e drejtpërdrejtë të zotërimit tonë në Vlorë, si edhe të truallit të saj, por edhe me mbarështimin e përgjithshëm të Adriatikut, që ishte një çështje jetësore për Italinë. Në kët fjalë të fundit të deputetit Savino vërehet qëndrimi kundërthënës (kontradiktor), që u duk në traktatin e Londrës të vitit 1915. Me Krispin, me Xhiolitin dhe me San Xhulianon, Italia e kishte vështruar gjithmonë Shqipërinë me ata sy, me të cilët Anglia shihte Belgjikën;

por kur iu desh të përballet me rrezikun e një lufte në Adriatik, Italia e shihte bregdetin vlonjat të Shqipërisë, ashtu siç e shikonte Anglia Gjibraltarin.

Dhe kjo pikëpamje mbizotëroi në pasluftën e mënjëhershme. Venizelosi ishte atëherë, i përkëdheluri (beniamini) i madh i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga frika se mos ndodhej e mënjëhershme në zgjidhjen e problemeve adriatike që e shqetësonin pas viteve të ankthit nën kërcënimin e flotës austro-hungareze, Italia shkoi në rrjedhën, qoftë edhe për pak muaj, që të kërkonte rishtazi çinteresimin e Greqisë në zotërimin tonë të Vlorës, me anë të marrëveshjes Titoni-Venizelos të 26 qershorit të vitit 1919. Kjo marrëveshje merrte parasysh edhe lëshime trojesh të Shqipërisë jugore në dobi të Greqisë. Sapo u njoh në Shqipëri ky pakt i Titoni-Venizelosit, për shkak të botimit në Athinë, një veprim i tillë zgjoi kundërveprimin më të ashpër antiitalian. Ky zemërim u shfaq në mënyrë të veçantë në Kongresin e Lushnjes, që u mbajt nga 21 - 31 janart 1920 .. Një hollësi shumë pak e njohur është se Kongresi i Lushnjes u mbodh me pëlqimin dhe me mirëkuptimin e autoriteteve italiane dhe se përfaqësuesit e Veriut të Shqipërisë, ndër të cilët shquhej si i parë Ahmet Zogolli i ri (mbreti Zog i ardhshëm), patën mjetet e shpenzimeve të rrugës nga përfaqësuesi italian në Shkodër. Një veçanti tjetër, edhe kjo pak e njohur, është se në këtë Kongres ishte i pranishëm edhe misionari amerikan, Eriksoni, që u përzgjodh, më vonë, si anëtar i delegacionit në Konferencën e Paqes (1).

Shqiptarët e Italisë Jugore, ndërkaq, kishin ngritur zërin kundër vazhdimit të qëndrimit, me mbarimin e luftës, të trupave italiane në Shqipëri, meqë një gjë e tillë kundërshtohet nga populli. Këto protesta u dëgjuan nga qeveria italiane, e cila filloi tërheqjen e trupave të saj nga Shqipëria. Në fund të majit të vitit 1930, e gjithë Shqipëria u zbraz (nga italianët,- p.), me përjashtim të Vlorës. Gabimit që të mbeteshin me forcë në Vlorë trupat tona, i dha fund Xhovani Xhioliti (Giolitti). Ai mbahej si simboli i një politike italiane vendosmërisht në dobi të pavarësisë së Shqipërisë. Si u kthye në fuqi, më 15 korrik 1920, ai shpalli në Senat se Italia duhej të ripohonte

politikën tradicionale të saj kundrejt Shqipërisë, sepse pavarësia e saj ishte njëra nga garancitë më të mëdha për lirinë e Adriatikut, në bregun lindor të të cilit, do të ishte në interesin tonë që të kishim një popull mik. Më 22 korrik 1920 qeveria italiane e denoncoi formalisht paktin Titoni-Venizelos.

Me protokollin e Tiranës për zbrazen e Vlorës, që u firmos më 2 gusht nga ministri i plotfuqishëm, konti Manxoni, u mbyll faza e marrëdhënieve italo-shqiptare, që kishin lidhje me Luftën I Botërore. Megjithatë marrëveshja me Tiranën nuk kishte kuptimin, - dhe për këtë kryeministri foli hapur, - e një mungese të interesimit të Italisë për Shqipërinë. Në po atë vit (1920), ai dha një provë të qartë me votimin në dobi të Shqipërisë, që kjo të pranohej si anëtare e Shoqërisë së Kombeve, sipas kërkesës që kishte bërë qeveria shqiptare më 12 tetor.

Sipas dëshmive dokumentare të markezit San Xhuliano, Italia vijoi të merrej me përforcimin e Shtetit shqiptar. Përgatitja dhe kultura e funksionarëve më të lartë të ministrisë së Jashtme ishte ende në traditën e veprimtarisë rilindëse të Italisë së Kavurit (Cavour), ta Maxinit, të Xhiobertit e të Mançinit. Për ata, Italia kishte dalë si një Shtet-komb në kornizën e një përtëritjeje europiane, në të cilën në liri dhe në përparim civil zëvendësoheshin grindjet dhe rivalitetet e Shteteve të dinastive nga marrëdhëniet e frytshme dhe nga bashkëpunimi i Shteteve kombëtare. Shteti italian, në mendimin e krijuesve të tij, kishte lindur për të ushtruar një detyrë të barazpeshës ndërkombëtare, në një risi të përgjithshme të madhe, në themele kombëtare. Paskuale Stanislao Mançini, që kishte përftuar normat e reja të kësaj bashkëjetese, kishte lënë, si ministër i Jashtëm, një gjurmë të shënuar në administratën që drejtonte. Ai ishte i mendimit se e drejta e përbashkët e pavarësisë kombëtare duhej të ishte e pajtueshme me detyrën e përbashkët për me respektue atë të tjetrit. Kjo ishte politika e zhvilluar nga Krispi në dobi të vendeve ballanike, që ishin në krizë të rëndë në vitet 1878-'88.

Në majin e vitit 1921 Shqipëria iu drejtua Shoqërisë së Kombeve, për ta ndërgjegjësuar për rregullimin e marrëdhënieve të saj me Shtetet fqinjë, që kishin nën pushtim të tyre ende troje të

përfshira brenda kufijve të vitit 1913. Përfaqësuesi italian, markezi Imperiali, ngulmoi, në kundërshtim me tezën e delegatëve grekë dhe jugosllavë, se kufijtë e Shqipërisë ishin përcaktuar prerazi në vitin 1913 në Firenze dhe se marrëveshjet ndërkombëtare të asaj kohe nuk ishin shfuqizuar (abroguar) ndonjëherë. Ai shtoi fjalë të një simpatie të gjallë për Shqiptarinë, dhe rikujtoi interesimin që Italia kishte mbajtur kurdoherë për lindjen dhe përparimin e Shtetit shqiptar. Ndërkaq përgatiti kërkesën që Këshilli të kërkonte nga Konferenca e Ambasadorëve, që ishte ngarkuar me këtë çështje, që të bente një ripohim të shpejtë të kufijve shqiptarë. Në të njëjtën mbledhje të 9 shtatorit, Konferenca e Ambasadorëve miratoi kërkesën për njohjen e Shqipërisë si Shtet i pavarur dhe sovran, me kufijtë e vendosur në vitin 1913.

Një Komision i përcaktimit të kufijve, i emëruar nga Shoqëria e Kombeve, erdhi menjëherë më pas në Shqipëri, por punët ecën me javashllëk për vështirësitë e shkaktuara nga Greqia për zbrazjen e Korçës, që i përkiste Shqipërisë. Vrasja e përfaqësuesit italian në Komision, gjeneralit Telini, e kryer nga anëtarët e komiteteve nacionaliste greke, krijoi pengesa të reja për vijëzimin e kufijve. Vetëm në tetorin e 1924-s Komisioni mundi të mbarojë punimet e tij.

Në po atë datë, më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve, e mbledhur në Londër, kishte pranuar sërishmi kufijtë e vjetër të Shqipërisë dhe kishte marrë një vendim tjetër me rëndësi të madhe që, ndërsa krijohet një siguri për gjallërimin e Shtetit shqiptar, njihet zyrtarisht interesin tonë për qëndrueshmërinë e mbarështimit të tij politik. Atje pohohej se dhunimi i kufijve dhe i pavarësisë së Shqipërisë, mund të shihej si një kërcanim për sigurinë dhe për strategjinë e Italisë dhe prandaj, në rastin që Shqipëria do të ndodhej në pamundësi për të ruajtur integritetin e vet tokësor, dhe i drejtohej Shoqërisë së Kombeve, qeveritë përfaqësuese u kishin dhënë udhëzime delegatëve të tyre në Këshillin e Shoqërisë së Kombeve, me porosi që rregullimi i kufijve tokësorë të Shqipërisë t'i besohej Italisë.

Ftohtësia që tregoi Zogolli, që sapo kishte ardhur në fuqi, në mbarim të vitit 1924, ndaj këtij institucioni ndërkombëtar, të bën të

dyshosh që ky institucion ishte për të, në atë kohë, burim i njëfarë shqetësimi. Jugosllavia e kishte pritur mirë përçarjen e saj për të pasur një cep rreth manastirit të Shën Naumit. Ahmet Zogolli ka gjasa që të ishte shqetësuar, atëherë, se ky ndryshim, sado i parëndësishëm i kufirit, do t'i jepte shkas qeverisë që në atë kohë kishte humbur pushtetin, me personat e saj, tani të mërguar jashtë vendit, që do të mund të kundërvepronin, duke vënë në veprim mekanizmin e parashikuar nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921.

Kështu Ahmet Zogolli kishte një interes të menjëhershëm për afrimin me Italinë. Por shkaku më i thellë që e nxiste ishte një tjetër: ai e dinte se kryengitja që më parë e kishte larguar nga fuqia, kishte gjetur tanimë një shkak në pakënaqësinë e nacionalistëve dhe në pjesën më të zhvilluar të popullsisë, kundër një qeverie në të cilën ishin përfshirë bejlerë, pronarë të mëdhenj tokash. Ata quheshin si kundërshtarë të reformave shoqërore dhe përgjithësisht të përparimit, meqë progresi do të bënte të nevojshëm pakësimin e pasurive të tyre, si edhe humbjen e prestigjit. Zogolli e kuptonte se një shkak i thellë i kryengritjes ishte edhe varfëria në të cilën jetonte populli dhe gjendja financiare e brishtë e Shtetit, e cila e pengonte organizimin e një force ushtarake, të aftë për të siguruar institucionet. Përvoja e tij vetjake në qeveritë në të cilat ishte pjesëtar, mbase e kishte bindur se fuqizimi financiar i Shtetit shqiptar, nuk mund të vinte dot nga Shoqëria e Kombeve. Nga ana tjetër një nevojë e tillë ishte e ngutshme, nëse ai donte të përforconte veprën që kishte kryer me një lëvizje të shkathët e të guximshme, që i kishin rikthyer fuqinë dhe e kishin prurë në krye të qeverisjes së Tiranës. Përvoja duhet t'i kishte vërtetuar edhe se nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Franca dhe nga Anglia, për rëndësinë e pakët që Shqipëria kishte në vështrim të interesave të tyre botërore, nuk do të kishte ndonjë mbështetje, sado të pakët, financiare. Atij me siguri duhet t'i kujtoheshin zhgënjimet nga aventurierë të panumurt që ishin derdhur si shiu nga çdo pjesë e botës, me premtime marramendëse dhe pastaj ia kishin mbathur më të katërta, pa paguar as hotelin!

Vendet që do të mundeshin, qoftë edhe për interesa të vetat, ta ndihmonin vërtet financiarisht Shqipërinë, ishin fqinjët: Jugosllavia dhe Greqia, apo edhe Italia. Jugosllavia dhe Greqia, që ishin financuar vetë nga Franca dhe nga Anglia, nuk mundeshin dot ose mbase nuk kishin interes që ta ndihmonin në rregullimin e gjendjes financiare Shqipërinë. Kështu Zogut (një shpend sipas shndërrimit të mbiemrit) nuk i mbetej veçse t'i drejtohej Italisë. Ky shtet përthithte në atë kohë dhe prej shumë vitesh më parë, katër të pestat e eksportimit shqiptar dhe furnizonte pjesën më të madhe të importimit. Edhe pa qenë nevoja të hapim statistikat, rëndësia e tregut italian për tregtinë shqiptare kuptohej edhe nga shkrimet në dyqanet e Barit, të cilat në qytetin e vjetër (città vecchia), ishin në rastet më të shumta në të dy gjuhët. Pra, prej kohësh ishte thurur një rrjetë marrëdhëniesh ekonomike që do të mundnin të lehtësonin interesin e kapitalit privat italian, sapo ai të kishte marrë zemër nga ndërhyrja zyrtare financiare e Shtetit tonë.

Komisioni hetimor, që dërgoi Lidhja e Kombeve nën drejtimin e profesor Sederholmit, pas Konferencës së Londrës së vitit 1921, kishte dhënë mendimin me shkrim, për marrëdhëniet italo-shqiptare se "nuk dukej që të kishte ndonjë pikë në të cilën interesat e të dy vendeve të binin në një konflikt të mundshëm. Përkundrazi: Meqë krahinat jugore të Italisë kanë një masë të bollshme popullsie shqiptare, Italia do të kishte një mundësi të padyshimtë që të ndikonte në të ardhmen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Shtetit të ri". Komisioni e kishte fjalën, kështu, jo vetëm për çështjet e nevojshme financiare, por edhe për ato teknike, si edhe për dërgim të ekspertëve pranë administratave shqiptare.

Mbase ishte tërësia e këtyre arsyeve që e kishte shtyrë Ahmet Zogollin, më përpara, madje, sa ai të merrte fuqinë në dorë, që t'i mbante të gjalla takimet me qeverinë Italiane. Qysh nga gushti i vitit 1924 ai kishte dërguar për këtë qëllim në Itali deputetin shqiptar Jak Koçi. Por atij i duhej një ndërmjetësi italiane. Në Vlorë, në Korçë, në Shkodër dhe në Durrës, kur ndodhnin intriga politike dhe turbullira, dukeshin të interesuara, për t'i ardhur në ndihmë vendit, disa nisma italiane. Këto nisma kishin shtysë, për më tepër, nga nxitjet e duhura të shqiptarëve të Italisë jugore, të vendosura në bregun tjetër të Adriatikut, që nga luftërat e para për pavarësinë, apo nga ish-ushtarakë, shpesh të martuar me gra shqiptare. Ata që kishin mbetur në Itali pas liritimit (nga ushtria, p.), kishin krijuar marrëdhënie vetjake dhe miqësi të ngushta. Pikërisht me këta italianë Koçi zgjodhi ndërmjetësit për të pasur takime me ndonjë personalitet të lartë italian. Dhe, meqë të

zgjedhurit e mundshëm për një punë të tillë ishin vëllezërit Xhildo dhe Karlo Punji, e këta ishin nga Liguria, deputeti Koçi iu paraqit deputetit të Savonës, profesor Aleksandër Lesonës. Këtij deputeti shqiptar iu dha mendimi që Italia të ndihmonte Ahmed Zogollin për forcimin e pushtetit në Shqipëri. Lesona foli për këtë me Musolinin, duke i vënë në dukje edhe se, sipas Koçit, njeri i afërt i Zogollit, (2) "Zogut i kishin dhënë fjalën për ndihma edhe qeveria jugosllave dhe se Anglia e shihte me sy të mirë një orvatje të tillë; por ai vetë, Zogu, ishte i bindur se Shqipëria do të zhvillohej vetëm duke u lidhur ngushtësisht me Italinë... Nga Anglia nuk kishte besim. -Ajo është mësuar prej shekujsh që të marrë pa dhënë asgjë,- tha Koçi. - Me Jugosllavinë Zogu nuk donte të kishte detyrime mirënjohjeje, për shkak të bindjeve të tij të prera që ta mbante gjallë çështjen e irredentizmit shqiptar të atyre anëve".

Bisedat nuk çuan në një përfundim, sepse Musolini kërkoi nga Ahmet Zogu një dokument me shkrim, të cilin ky i fundit nuk mund ta jepte, për të mos u dhënë jugosllavëve një gur në dorë.

Menjëherë pas ardhjes në fuqi dhe ndërsa i dërgonte telegrame Musolinit dhe ministrit të Italisë në Shqipëri, Ahmet Zogu e nisi Koçin për në Itali. Takimet i mori sërishmi me deputetin Lesona. Rruga diplomatike e zakonshme dukej sheshit që nuk ishte e pranueshme për Presidentin shqiptar. Mjaft ndjekës të regjimit të tij, që e kishin kaluar kufirin kohët e fundit së bashku me të, kishin rënë nën ndikimin jugosllav. Shumë përfaqësi të dyshimta, që të mos themi armiqësore, e rrethonin legatën e Italisë.

Lesona vajti fshehurazi në Shqipëri dhe u takua me Ahmet Zogollin, në çiflikun e tij të Matit. Presidenti ia tha hapur se regjimi i tij " duhej të ishte fatalisht autoritar dhe nacionalist, sepse irredentizmi shqiptar (kundrejt Jugosllavisë dhe kundrejt Greqisë) është zëri i madh e i vetëm i cili, duke i folur zemrës së popullit tim, mund ta mbajë atë të bashkuar. Italia duhet ta kuptojë me siguri këtë frymëzim, sepse edhe ajo vetë është ndeshur për

irredentizmin e bijve të saj" (2).

Pas kthimit të Lesonës në Itali e pas shumë bisedash me sekretarin e përgjithshëm të ministrisë së Punëve të Jashtme, kërkesat tona qenë për qëndrimin e prerë të Musolinit, të konkretizuara në "një traktat të fshëhtë ushtarak, sipas të cilit Shqipëria do të vinte në dispozicion të Italisë truallin e saj në rastin e një lufte me Jugosllavinë; do t'i jepte në koncesion Italisë zonat naftëmbajtëse, koncesione bujqësore në zona që do të përcaktoheshin; do të ngrihej Banka e emetimeve shqiptare me kapitale italiane" (2).

Kjo pjesa e fundit e traktativave, që përfshinte edhe krijimin e Bankës së emetimeve, u zgjidh më lehtësisht.

Dëshira e Presidentit të Republikës shqiptare, që të lidheshin sa më shpejt marrëdhënie miqësore me Italinë, gjeti në këtë kuptim një truall të dobishëm në gjendjen që u ravijëzua pranë Komisionit ekonomik dhe financiar të Shoqërisë së Kombeve. Propozimi i fundit i Albert Kalmesit, ekspertit të ri të Shoqërisë së Kombeve, për të krijuar në Shqipëri një Bankë emetimesh "me synimin për të përshpejtuar përparimet e Shtetit të ri, jo vetëm në fushën ekonomike por edhe në ecjen drejt civilizimit", kishte gjetur miratim në këtë seli.

Komisioni ekonomik-financiar i Shoqërisë së Kombeve, pasi kishte caktuar asetet dhe funksionimin e një Banke të emetimit në Shqipëri, u këshillua me anetarët e Shoqërisë së Kombeve për ndihmesën financiare që do të jepte secili për Institutin që do të krijohej. Raporti i Kalmesit e kishte përcaktuar krijimin e kësaj banke të emetimit si "një punë të mbarë për të gjithë ata që do të kishin guximin ta ndërmerrenin". Megjithatë, mbase për shkak të dyshimit që në Shqipëri do të mund të pranohej një letër monetare e besueshme, meqë "nuk ka besim pa siguri", vetëm Italia, Belgjika dhe Zvicra iu përgjigjën thirrjes së Shoqërisë së Kombeve. Iu besua Italisë detyra që të zbatonte nismën. Në marsin e vitit 1925, për hir të shërbimeve të mbara të deputetit Lesona, si edhe falë veprimtarisë së të ngarkuarit me punë në Shqipëri, Ugo Solas, u bë e mundur dalja e një konvente ndërmjet qeverisë shqiptare

dhe një grupi financiar, që vepronte edhe për llogari të kapitalistëve zviceranë dhe belgë, që u interesuan, qoftë edhe për shifra të ulëta. Në këtë grup bënin pjesë bankat më të mëdha italiane, me një epërsi të Kreditit Italian, që kishte si eksponent Mario Albertin, i njohur mirë në mjediset ndërkombëtare për veprimtarinë që ai kishte bërë në fillimin e pasluftës. Menjëherë qeveria shqiptare nxori "Ligjin e rregullimit monetar të Shqipërisë". Kështu lindi, më 12 shtator të vitit 1925, "Banka Kombëtare e Shqipërisë" që pati të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës letër.

Njëkohësisht u ngrit edhe "Shoqëria për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë" (S.V.E.A.) me detyrën "që të përballonte nevojat më të ngutshme të popullsisë, në drejtim të punimeve publike e të zhvillimit bujqësor dhe industrial", me anë të një huaje prej 50 milionë frangash ari. Huaja ishte tërësisht italiane, një hua e parë me njëfarë vlere, kjo, që kishte marrë Shteti i ri shqiptar. E vërteta se Italia, me anë të huas së S.V.E.A.-s u njoh si subvencionuese e përngjashme me veprimtarinë financiare të Francës dhe të Anglisë në dobi të shteteve të tjera ballkanike, kishte zgjuar kritika në mjediset angleze dhe amerikane.

Ministri i Anglisë, Sër Herri Ajrs, mik vetjak i Ahmet Zogut, i cili e kishte ngarkuar si shpjegues (interpret) të këtyre kritikave e të këtyre shqetësimeve, pati si përgjigje: -"Më besoni. Unë s'do të bija kurrë në krahët e Italisë". Këto pyetje e përgjigje dëshmonin sesa e vështirë ishte udha për t'i dhënë një pamje moderne dhe jetësore Shtetit shqiptar. E kjo veçanërisht për shkakun se, siç kishte ndodhur edhe me ndihmat që kishin marrë Shtete të tjera ballkanike nga fuqitë perëndimore, duhej që marrëdhëniet ekonomike të përfshiheshin në një marrëdhënie politike, që të përlligjeshin përballë opinioneve publike përkatëse, në pamje të vazhdimësisë së procesit.

Në Kujtimet e tij (2) deputeti Lesona tregon me mjaft besueshmëri fazat e vështira dhe shpesh tronditëse për nënshkrimin e marrëveshjes së fshehtë politiko-ushtarake, që do të përbënte hyrjen në marrëdhëniet politike, që s'mund t'u

shmangeshin publicitetit.

Marrëveshja parashikonte edhe dërgimin e disa oficerëve italianë të artilerisë dhe të marinës si instruktorë pranë forcave të armatosura shqiptare, të cilat Presidenti i Republikës i kishte mjaft për zemër. Deputeti Lesona i kishte marrë udhezimet nga sekretari i përgjithshëm për Punët e Jashtme. Ministri i Italisë në Shqipëri, markezi Duraco, ishte mbajtur në dijeni të traktativave nga vetë deputeti Lesona.

Musolini i ndiqte vetë përparimet e kësaj marrëveshjeje. Për të zbërthyer disa formula që kishin shkaktuar ngecje, u dërgua në Tiranë ministri i plotfuqishëm Lo Jakono, titullar i zyrës së Shqipërisë në ministrinë e Jashtme. Marrëveshja e fshehtë më së fundi u firmos në vjeshtën e 1925-s. Ajo përmbante një frazë që e shqetësonte senatorin Kontarini: ishte ajo që parashikonte, në rast të një lufte, që të mos kishte marrëveshje nga ana e Italisë, që të mos merrte parasysh fatin e të gjitha popullatave të gjuhës shqipe. Deputeti Lesona sqaron se "përmendja e popullatave shqiptare në marrëveshjet e mundshme të paqes (nga ana e Shtetit italian,- p.), ishte shkaku kryesor (pengesa kryesore) që Zogu të mos pranonte klauzola (të tjera) në dobi të Italisë" (2). Shqetësimi i sekretarit të përgjithshëm të ministrisë së Jashtme kishte të bënte me atë se, po të zbulohej kjo klauzolë, traktati do të ndikonte thellësisht (për keq,- p.), në marrëdhëniet e Italisë me Jugosllavinë. Atëherë u kërkua në Pallatin Kixhi një formulë që ishte në modë në atë kohë, sipas së cilës marrëdhëniet ndërmjet Italisë, Shqipërisë dhe Jugosllavisë të paraqiteshin si një model lokarnian (që nuk mohonin vendimet e marra në Lokarno,- p.).

Traktati i fshehtë u përfundua si hyrës ose si paraprak për një traktat të mëpastajmë të hapur të miqësisë, që do të regjistrohej pranë Shoqërisë së Kombeve. Për përpilimin e këtij të fundit kishin nisur menjëherë bisedimet me vetë deputetin Lesona. Ministri i Jashtëm italian dëshironte që traktati të përmbante një ndërlidhje të hapur me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1921. Kjo tërheqje për ligje (justifikohet) me druajtjen se

Shqipëria mund të përdorte të drejtën që ta ndërfaqte Italinë, sa herë të donte, në veprime luftarake kundër njërit nga komshijtë e saj, kundrejt të cilëve do të ngrinte mëtime tokësore. Nga ana tjetër qeveria shqiptare nuk e fshihte sesa e vështirë do të ishte për të që të pranonte nga mjediset nacionaliste të Tiranës, që këto t'i përplasnin fytyrës një dokument, shpirti frymëzues i të cilit të zgjonte njëfarë mosbesimi për të ardhmen e Shtetit shqiptar.

Në këtë gjendje të ndërlikuar, në fillim të shkurtit të 1926-s, ministri i Jashtëm e gjeti të nevojshme dhe të ngutshme që t'i fuste të gjitha trakativat me Shqipërinë në shtratin e zakonshëm diplomatik. Dhe, meqë i ngarkuari me punë, markezi Asereto, ishte sëmurë, i kërkoi baronit Aloizi, që ishte ministër në Bukuresht, që të merrte sa më shpejt drejtimin e delegacionit të Italisë në Durrës. Baroni Pompeo Aloizi ishte një person i zgjuar dhe i pajisur me një hir (tërheqje) të madh vetjak. Fjalëmaturo dhe i pëlqyer në bisedë, kishte përfituar nga edukata e shkollës detare ushtarake që kishte kryer. Ai ishte bërë i besueshëm në mjediset në të cilat gjithmonë je i detyruar t'i përgjigjesh ndershmërisë me ndershmëri.

KREU I

PËR SHËNDOSHJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË

Caktimi im i parë në Shqipëri – Traktativa ekonomike – Nisja e veprimeve të Bankës Shqiptare dhe të S.V.E.A.-s – Porti i Durrësit – Projekte të përtëritjes së rrugëve të komunikimit – A.I.P.A. (Ndërmarrja tregtare e naftës në Shqipëri) – Aparatet telegrafike dhe telefonike – Drunjtë e Matit – Peshkimi – Kadastra – Konventa arkeologjike.

Në fillim të 1926-s ndodhesha në Londër, ku punoja si sekretar i Komisionit për rregullimin e detyrimeve të luftës ndërraleate përkundrejt Anglisë. Atje mora njoftimin se sekretari i përgjithshëm i ministrisë së Jashtme, Antonio Kiaromonte Bordonaro, dëshiroonte të më takonte sa më shpejt për të folur për caktimin tim me punë në Tiranë.

Si mbërrita në Romë, ai më tregoi shkaqet për të cilat më zgjodhën si sekretar të parë të legatës sonë në Tiranë. Baroni Pompeo Aloizi, që sapo kishte ardhur si kryetar i misionit, ishte thirrur shpesh në Romë për të bashkërenditur dora-dorës fazat e programit të ri që ishte vendosur të zbatohet në Shqipëri: sekretari i parë duhej të drejtonte, pra, për një kohë të gjatë, delegacionin. Detyra duhej t'i ngarkohej vetëm personit që gëzonte besimin e ministrisë dhe që ishte në marrëdhënie të afërta me baronin Aloizi.

Me dashamirësinë e tij ta zakonshme, sekretari i përgjishëm i ministrisë së Jashtme më vuri në dijeni se funksionarët e lartë të Ministrisë, sidomos ata që kishin qenë nxënës të San Xhulianos, e shihnin me simpati atë caktimin tim, sepse ishte e njohur besnikëria ime ndaj atij që quhej si njohësi më i mirë italian i gjendjes shqiptare. Idetë e markezit San Xhuliano i njohja shumë mirë, në të vërtetë, sepse ai kishte pasë qenë në marrëdhënie shumë të ngushta me babanë tim, në një punë të përbashkët për veprimtarinë tonë ekonomike në Lindjen e Mesme, që kishin zhvilluar veçanërisht për veprimtarinë e Bankës së Romës, në udhën e një tradite të lashtë italiane. Me baronin Aloizi isha në miqësi dhe kisha një marrëdhënie të singertë, për shkak të një bashkëpunimi të gjatë. Kisha marrëdhënie të afërta me të në vitin 1919 në Paris, ku drejtonte zyrën e shtypit të delegacionit italian dhe pastaj në Bukuresht, ku kisha qenë prej dy vitesh, në cilësinë e sekretarit të legatës, që kryesohej nga Aloizi. Njihesha si një studiues i çështjeve danubiane-ballkanike: Në Paris, në Kongresin e Versajës të vitit 1919, kisha mbajtur marrëdhëniet me delegacionin austriak, hungarez dhe me atë bullgar. Kjo më kishte dhënë rastin e qëndrimeve të gjata në Vjenë, në Budapest dhe në Sofje, i dërguar me shërbim pranë atyre që atëherë quheshin komisaritate të larta në kryeqytetet e të Shteteve të mundura. Kisha marrë pjesë në Konferencën për rregullimin e lundrimit në Danub; në Konferencën e Romës ndër Shtetet që kishin dalë nga monarkia austro-hungareze; në atë të Portorozes, për një rregullim të ri ekonomik të pellgut (basenit) danubian-ballkanik. Për pasojë isha, ndonëse në mënyrë të tërthortë, në dijeni edhe të ndeshtrashave (të peripecive) të popullit shqiptar, të krenarisë së tij, të gjendjes së tij shpirtërore jobesuese, si edhe të ngushtësive të tij financiare, që pengonin përparimin e tij civil.

Unisa në fillim të prillit. Udhëtimi në det nga Bari në Durrës (rreth 70 km), në kushte tepër të vështira të detit të dallgëzuar, udhëtim që zgjati 48 orë.

Një mjet lundrues m'u dërgua nga delegacioni për të më

tërhequr, në një det të trazuar sepse, edhe në kushte më të mira atmosferike, me një avullore, qoftë edhe të lehtë, nuk ishte e mundur të afroheshe së paku një km nga toka. Më së fundi zbrita përballë fortifikatave venedikase të kalasë së vjetër dhe u ndodha i rrethuar nga një turmë që u ofronte të sapoardhurve çibukë, bastuna, breza, sende prej argjendi apo prej druri me piktura të forta, qilima, të gjitha këto punime të artizanatit të vendit. Kishim përpara fytyra të hequra dhe trupa të dobësuar nga malaria. Megjithatë, në hijen e tyre të rëndë dhe në mënyrën e paraqitjes së sendeve që i kishin prurë për tregti, ata njerëz, ndonëse me rrobe të përdorura shumë, në ngjyrë të zezë e të bardhë, tregonin dinjitet dhe elegancë sjelljeje.

Edhe nga "kafazët", roja vetjake të përfaqësive diplomatike, sipas zakoneve të Lindjes, që më shoqëronin, pata menjëherë një përshtypje jo të pëlqyeshme për mjedisin ku isha caktuar të qëndroja.

Elektriciteti e gazi mungonin. Asnjë ndriçim publik. Rrugët, në sheshin e Durrësit, ishin ato që tanimë nuk vlenin, të kohës së vjetër romake; rrugë bagëtish me baltë të rrahur, në të cilat shkonin zakonisht kope dhe kuaj, kafshë ngarkesash apo qerre të tërhequra nga buaj. Lumenj pa ura: kalohej nëpër vahe apo me trape, në vendet e thella. Fshatrat, të pasigurt për shkak të gjakmarrjes. Ujët e pijshëm ishte shumë i rrallë dhe çohej në qytete si një mall tregu nga shitës bredhës (ambulantë) që e mbartnin nëpër gjyma prej bakri, të skalitur artistikisht. Gjatë brigjeve shtriheshin hapësira të mëdha, të pushtuara nga ujërat e lumenjve të cilët, si zbritnin në fushë, krijonin kënetë që ndërronin vend. Kope buajsh i jepnin njëfarë ngjyrimi dhe sikur e gjalloronin paksa atë shtrirje moçalesh nëpër të cilat kalonin, pa e ngatërruar udhën, buajt në drejtime të caktuara, në të cilat ndodhej njëfarë kalldrëmi që në kohën e romakëve, për të mos u mbytur në llum. Shtëpitë, më të shumtat njëkatëshe në Shqipërinë e mesme, ishin të ndërtuara me tulla të pjekura në diell, për mungesë gurësh. Bujqësia, tërësisht parake (primitive), kufizohej përgjithësisht në kulturën e grurit dhe punohej vetëm me parmenda druri. Perreth Krujës

ngriheshin ullinj gjigantë, që i kishin mbjellë venedikasit, me pagesë monedhash metalike. Industria mbetej vetëm në punën e zanatçinjve; çdo familje punonte për vete: Gratë thurnin, punonin e qepnin rrobe dhe qilima, me leshin e bagëtive të tyre. Kartonedhat dhe çequet bankare nuk ishin ende në përdorim. Përçapjet e para për të përhapur përdorimin e kambialeve u pritën me përbuzje, sikur aktet e shkruara të ishin një fyerje për ata banorë, të mësuar në respektimin e fjalës së dhënë. Portat e jashtme të shtëpive nuk ishin të pajisura me brava, sepse hajdutllëku dhe grabitja nuk njiheshin. Pjesa dërmuese e popullsisë ishte e përfshirë nga analfabetizmi dhe kryqi në trajtën e një vule, në një shkrim para dëshmitarësh, kishte vlerën e firmës edhe për myslimanët. Në ditët e pazarit grumbulloheshin njerëzit të shkruarit publikë, kur donin të shkruanin letra, apo të bënin ndonjë dokument.

Ndryshesat shoqërore ishin tepër të mëdha. Vendin e drejtësisë si institucion e zëvendësonte hakmarrja vetjake, ndonëse Shteti kishte botuar kode të mira e moderne, ku kishte dhënë ndihmesën e vet edhe prefekti italian Munzinger. Respektimi i rregullit, në hakmarrjet private ishte i siguar, veçanërisht në malësitë, duke u respektuar normat zakonore që përmbante Kanuni si edhe ligjet e pashkruara. Tirana, që ishte bërë kryeqytet para pak vitesh, ishte një fshat që mbase kishte pesëmijë frymë. Në sheshin e tregtimeve shiheshin herë-herë të varur trupat e të dënuarve.

Përshtypjet për gjendjen e prapambetur materiale të vendit ishin të dhimbshme, por në pak kohë krijova bindjen se për këtë nuk duheshin fajësuar shqiptarët. Në ankthin për të zënë kohën e humbur, ata ishin për më tepër të parët, veçanërisht në vendet më të përparuara, si në Shkodër dhe në Korçë, që nxirrnin në pah të keqen që kishte gllabëruar vendin.

Ndër këto, ajo që kërkonte një ndreqje sa më të shpejtë, ishte prapambetja ekonomike e cila, në malësitë, gjatë dimrit, merrte përmasa të tilla sa kërcënohej vetë jeta e popullatave, si edhe ajo e Shtetit. Dhe delegacioni merrej pikërisht me problemet që

kishin të bënë me vënie në veprim të mekanizmave të parashikuara nga krijimi i Bankës dhe i S.V.E.A.-s, kur erdha në Shqipëri. Ishte e ngutshme, mbi gjithçka, që t'i jepej punë popullit, të zhvillohej tregtia e brendshme dhe e jashtme me një mjet të sigurt këmbimi, si edhe të hapeshin rrugë komunikimesh. Në mbështetje të pororsive që kishte dhënë Roma, përmes baronit Aloizi, me të marrë drejtimin e përfaqësimit tonë diplomatik, filloi puna e përkushtuar, që t'u jepeshin zgjidhje problemeve që përmendëm.

Punët ngushtësisht politike sikur ishin lënë fillimisht mënjanë. Kjo sepse, nga të dhënat e Shtatmadhorisë sonë, sikur kishte lindur njëfarë dyshimi se mos Qeveria shqiptare, njëkohësisht me traktatin e fshehtë me ne, kishte firmosur edhe dy të tjera si ai yni me Jugosllavinë e me Greqinë. Mendohej se do të shoshiteshin keto të dhëna për të mbërritur në një përfundim që t'i përgjigjej së vërtetës. Por, meqë Qeveria shqiptare po e ndiqte sinqerisht programin ekonomik të përgatitur, duke e mbështetur zhvillimin e Shqipërisë në ekonominë italiane, ishte e vështirë të besohej se ishin në fuqi edhe pakte të tjera me Jugosllavinë dhe me Greqinë.

Një shkak i gjendjes konkrete ndërkombëtare të bënte që të mos nxitoheshim në biseda politike të shpejta. Traktati i miqësisë italo-jugosllave i 27 janarit të vitit 1924, doemos që e bëri të prekshëm (delikat) atë të mëvonshmin, domethënë marrëveshjen për S.V.E.A.-n si edhe për Bankën e Shqipërisë dhe do të duheshin informata më të shumta, për ta nxjerrë Italinë nga gjendja e rrezikshme në të cilën ishte futur, ndërmjet Francës dhe Jugosllavisë. Qeveria franceze kishte bërë gjithçka për të ndaluar përfundimin e një marrëveshjeje italo-jugosllave. E kishte marrë këtë punë me aq mëri, sa i kishte nxjerrë lejepushimin, në shtator, ambasadorit të Francës në Romë, atij Barrierit (Barrière) të moshuar që, me përfitim të madh, kishte pasë ndikuar, në 1915-n, që Italia të hynte në luftë përkrah Francës. Ne duhej të mos e zemëronim Jugosllavinë por, në të njëjtën kohë, duhej edhe të siguronim interesat tona në Shqipëri, ndaj së cilës, një qëndrim i vëndosur yni, do të quhej si një synim i mundshëm për të

mënjanuar jugosllavët.

Një shkak tjetër për të qenë të matur në qëndrimin tonë politik ndaj Shqipërtisë vinte nga demonstratat pro Dalmacisë, që në atë kohë ishin bërë të shpeshta në Itali; këto lëvizje në vetvete ishin bërë një burim shqetësimi për Jugosllavinë. Këto ishin edhe arsye të cilat i kishte parasysht legata jonë e cila, për këto shkaqe, merrej më shumë me traktativa ekonomike, më pak shqetësues në rrafshin ndërkombëtar të cilat, megjithatë, ishin të kreshpëruar (të mbushur përplot) me ndërlikime.

Po mbaronte afati i kështit të parë të huas që ishte marrë një vit më parë qeveria shqiptare me S.V.E.A.-n dhe vështirësitë që dilnin nga formalitetet për zbatimin e marrëveshjes. Ishtë në vijim marrëveshja për ndërtimin e portit të Durrësit, për projektin e të cilit ishte interesuar një as i kësaj dege, inxhinier Luixhi Luixhi (Luiggi); po bisedohej edhe për shitjen e pyjeve të Matit, që u duheshin hekurudhave të Shtetit tonë, për drunjtë që do të shërbenin si traversa për shtrimin e shinave; ishin në bisedë edhe koncesionet për ndërtimin e impianteve telegrafike dhe telefonike. Nga ana tjetër qeveria shqiptare kërkonte edhe një hua për qytetet e Durrësi dhe të Tiranës. Hartimi i planit rregullues të të dy qyteteve i ishte besuar një italian: arkitektit Brazini. Kishin zënë fill, përmes legatës sonë, traktativa të qeverisë shqiptare me Institutin Gjeografik ushtarak të Firences. Pritej nga dita në ditë mbërritja e një misioni të kryesuar nga vetë drejtori i Institutit, koloneli Ferrara, për rievime topografike dhe për ndërtimin e kadastrave shqiptare.

Ishte bërë edhe një kërkesë nga pala shqiptare që Italia të studionte mundësinë për të krijuar një shoqëri që do të përmirësonte shfrytëzimin e peshkimit, që ishte i pasur në Shqipëri, si në detet ashtu edhe në liqenet dhe në lumënjtë e shumtë. Ishte në studim e sipër bonifikimi i Myzeqesë, - një sipërfaqe tepër e madhe, por vende-vende kënetore, parajsa e zogjve ujorë, që shtrihej nga Vlora gjer në Rogozhinë, një qytet i vogël afër Durrësit. Së fundi, po shqyrtohej mundësia e ndërtimit të një hekurudhe që të ndiqte përafërsisht gjurmët e Aeganitia-

s, gjer në Follorinë të Greqisë.

Ministri i atëhershëm i Financave, konti Volpi, bënte të ditur të gjitha vështirësitë që do të haseshin nga këto projekte, por në të vërtetë iu nënshtrua zbatimit të këtyre projekteve, me kusht që të jetësoheshin me shpirtin e kursimit dhe me kritere të frytshmërisë. Ai ishte një personalitet i madh i botës financiare dhe njohës i Shqipërisë, qoftë se e kishte përshkuar në rininë e tij, qoftë se ishte pronar i industrive të rëndësishme në Tivar të Malit të Zi, pranë kufijve shqiptarë. Ai e kishte bërë zakon të thoshte se trualli shqiptar ishte i varfër pikërisht sepse shkëmbinjt e vendit, që shpesh gjendeshin nën një gisht dhezëzë (humus) ishin të pasur në minerale në përqindje të mëdha metalike: krom, hekur, bakër dhe, siç thuhej, zink dhe amiant. Thoshte edhe se, sipas njohjeve të veta shkencore, kaskadat e lumit Drin, të vendosura në dalje të liqenit të Ohrit, pranë tij, ishin në gjendje që të furnizonin energji elektrike dhe ndriçim për Shqipërinë, për Greqinë dhe për Italinë Jugore.

Çështja më e flaktë në bisedim ishte koncesioni i një zone naftëmbajtëse në luginën e Devollit, që kufizonte me lumin Seman, zonë e cila kishte shenja të forta për nxjerrje të shumtë të naftës. Shoqëria anglo-persiane e që kishte marrë, më parë, në koncesion një sipërfaqe në rrethinat e Patosit, pikërisht ato ditë kishte pasur një përfundim të rëndësishëm, sepse kishte dalluar një damar naftë vetëm në 260 metra thellësi.

Bashkërisht me këto traktativa të natyrës ekonomike, po zhvilloheshin, në këto ditë, bisedimet për një furnizim armësh dhe pajisjesh, gjithmonë në përputhje me marrëveshjen e 1921-shit, për modernizimin e ushtrisë shqiptare, sipas modelit italian. Në krye të këtij misioni ushtarak në Shqipëri ishte majori i ri i atëhershëm i artilerisë, Montalbano.

Ishin në përfundim, në të njëjtën kohë, edhe disa marrëveshje të një karakteri tjetër, por edhe ato mjaft interesante politikisht, sepse shërbenin për të vërtetuar lidhjet shumë të vjetra që bashkonin Shqipërinë me Italinë. Ato kishin të bënin me një koncesion arkeologjik, për të cilin punonte me një zjarr të

paarritshëm profesor Ugolini. Punimeve të tij u deturohen nxjerrjet në dritë të monumenteve tepër të rëndësishme të qytetit shumë të vjetër të Butrintit. Këto zbulime po bënin të pranueshme hamendësinë (hipotezën), gjer atëherë në diskutim, të analogjisë etnike të brigjeve adriatike të Italisë, sidomos të Venetos dhe të Puljes, me brigjet shqiptare.

Punimet historike dhe prehistorike të profesor Ugolinit, studimet e tij të ngjashmërive të ndodhive dhe të veshjeve në të dy vendet, si edhe të tjerat që shërbenin për të vërtetuar burimet e njëjta, përbënin elemente të rëndësishme në synimin për një bashkëjetesë më të mirë në të ardhmen, ndërmjet të dy popujve.

Ngulmimi shqiptar në projektimin e lidhjeve gjithmonë e më të reja ekonomike me Italinë, ndërkaq po i zhbënte dyshimet që kalleshin nga disa, për qenien e një traktati të fshehtë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Nëse do të ishte firmosur një gjë e tillë nga Ahmet bej Zogolli, kjo do të mund të ndodhte para se ai të kthehej në Shqipëri, kur nuk ishte veçse një privat i thjeshtë. Nga sa thuhej për pakënaqësitë jugosllave për dhenien e një huaje nga S.V.E.A., kjo u vu re edhe nga mënyra e të shprehurit nga ana e shtypit të Beogradit, gjë që dëshmonte për një trysni politike ndërmjet këtyre dy vendeve (dhe jo për marrëdhënie të afërta, - p.). Tanimë ishin zvogëluar ndjeshëm shqetësimet italiane në mirëbesimin shqiptar. Por po zgjohej njëfarë druajtje se forcimi i marrëdhënieve me Shqipërinë, mund të ndikonte (për keq, - p.) në marrëdhëniet tona me Jugosllavinë. Nga konsullata e Shkodrës vinin lajme se në Jugosllavi po krijoheshin banda të armatosura, me detyrën që të krijonin turbullira në truallin shqiptar. Flitej se po derdhej para e madhe dhe po nderoheshin e po sajdiseshin personalitete shqiptare të zonave kufitare (për të krijuar turbullime, nga jugosllavët, - p.). Miku vetjak i Zogollit, deputeti Koçi, erdhi ato ditë me disa të tjerë se mos krijohej mundësia që të gjendej në Itali një nuse për presidentin e Republikës dhe fjala ra te princesha Xhovana e Savojes. Koçi e solli muhabetin edhe nëse mund të shihej e udhës që të përgatitej mjedisi në Pallatin Kixhi për shndërrimin e Republikës shqiptare në mbretëri dhe

për ngritjen në fron të Presidentit.

Në ditët e para të majit, me mbërritjen e ministrit të plotfuqishëm anglez, O'Reilly, u duk të përvijojë në Shqipëri një kundërvënie kundër marrëveshjeve me Italinë. Kjo frymë kundëritaliane dukej se kishte përfaqësuesen e saj te Ledi Karnavon, që kishte ardhur pas ministrit anglez dhe kishte vënë në përdorim fonde të majme, edhe nga të sajat, në vepra bamirësie: Ajo hapi bibliotekën (që mori emrin e saj,- p.) dhe ngriti disa laboratore ku u punësuan gra shqiptare. Ledi Karnavon ishte e ëma e kolonelit Herbert i cili, në të kaluarën, i kishte bërë mjaft shërbime Shqipërisë dhe atje kishte një popullaritet të gjerë. Përreth pranisë së kësaj dame angleze në Tiranë, si edhe të mikeshës së saj, zonjushes Penington në Durrës, lëshonin frerin fantazitë nga më të ndryshmet. Dhe nuk arrija të kuptoja, në atë kohë, sesa e thellë, e shkathët dhe e durueshme ishte depërtimi anglez në Shqipëri dhe, në përgjithësi, në vendet ballkanike. Ishte fryti i pastriotizmit të singertë, në sajë të të cilit çdo anglez jashtë vendit të tij e ndjente për detyrë të ofrohej për të mirën e atdheut të vet. Një përvojë të tillë Italia e kishte që në vitin 1920, në kohën e turbullirave të Vlorës. Çdo kundërveprim i yni në rethet shqiptare ku vepronin anglezët, gjithmonë kundër nesh, ashtu siç vepruan edhe në 1920-n, ishte i pafrytshëm. Kur paraqitej ndonjë rast që na zgjonte pakënaqësi, duhej ndërhyrë në Londër e jo në Durrës për të, asnjënjësuar veprën e zhvilluar kundër nesh nga agjentët anglezë.

Ajo që synonim të hiqnim nga truri i anglezëve ishte shqetësimi i *Foreign Office*-it se kontrolli ynë i të dy brigjeve të kanalit të Otrantos, mund t'i cenonte interesat britanike në Mesdhe.

Më 9 qershor legata jonë mori urdhrin e ministrisë së Jashtme që t'i shkohej, tashmë, në fund traktativave politike për paktin e miqësisë dhe të sigurisë. Në Romë mendoninin tani se fryma ndërkomëbetare ishte e volitshme që të përfundohej një pakt, i cili të ligjësonte para botës tërësinë e marrëdhënieve italo-shqiptare. Nuk pretej më që të kishte nga ana jugosllave kundërveprime të forta. Për çdo rast, do të duhej, megjithatë,

që Qeveria shqiptare të vihej në kushtet për t'u bërë qëndresë kryengritjeve të mundshme që jugosllavët kishin nxitur në Shqipëri, - dhe do të vazhdonin ta bënin këtë edhe më pas -. Ministria, ndërkaq, ishte e gatshme për të përmbushur kërkesat shqiptare për armatim dhe për dërgimin e instruktorëve për dy divizione, kërkesë që lejohej nga gjendja që krijonte për Italinë deklarata e 1921-shit. Po ta donte nevoja, ministria ishte e prirur edhe që ta shtynte botimin e traktatit të miqësisë, gjersa t'i siguroheshin Shtetit shqiptar mjetet për t'u mbrojtur nga rreziqe të mundshme të jashtme. Pas firmosjes së traktatit, kryetari i Qeverisë italiane, do të ishte i lumtur që të takonte Presidentin. Flitej se takimi mund të bëhej në det apo në Ankonë. Prandaj, përveç të gjashtë MAS-ve (mezzi armati siluranti), që kishte kërkuar qeveria shqiptare për të krijuar një marinë të sajën ushtarake, ministria jonë e Jashtme, ishte e gatshme që të jepte edhe një jaht, sipas dëshirës që kishte shprehur Presidenti.

Nëse në Romë gjendja ndërkombëtare paraqitej e volitshme, në Durrës legata nuk ishte e të njëtit mendim. Pikërisht atëherë ishte firmosur traktati tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Thuhej se ai e tejkalonte së tepërmi, në përmbajtjen e tij, përmasat e një traktati të zakonshëm tregtar dhe përmbante, madje, edhe klauzola të një natyre politike. Madje më 10 qershor qeveria shqiptare vuri në dijeni legatën tonë se një deputet jugosllav, në emër të Qeverisë së tij, bënte një ofertë për një furnizim të plotë të të gjithë materialit ushtarak për të cilin Shqipëria kishte nevojë, me një afat pagese afatgjatë. Kjo ofertë ishte lënë pezull. Më pas legata u vu në dijeni edhe se i ngarkuari i Punëve të Francës kishte vajtur te Presidenti, në mbështetje të ofertës jugosllave. Të jepej përshtypja se po krijohet një koalicion kundër përparimit të veprave tona në Shqipëri.

Presidenti dukej se nuk ishte i shqetësuar. Ai shprehej gjithmonë kundër përmendjes së vendimit të 1921-shit të Konferencës së ambasadorëve, në paktin tonë politik. Ai thoshte se kjo kishte të bënte edhe me prestigjin e tij vetjak, me qenë se, në vitin 1921, si kryetar i Këshillit, ai e kishte kundërshtuar

burrërisht pranimin e atij vendimi. Për vështirësinë e gjendjes së tij, ai donte të bisedonte drejtpërdrejt me kryetarin e Qeverisë italiane por takimi, sipas mendimit të tij, nuk mund të bëhej para fundit të shtatorit, meqë vetëm në atë kohë, si të kishte plotësuar elementët e prefekturave me elementë të sigurt, mund ta linte i qetë Shqipërinë. I thamë se do të ishte me vend që të të mos ia komunikonim Romës (atë shtyrje,- p.), sepse mund të hapeshin dyshimet për marrëveshjen shqiptare me Jugosllavinë. Presidenti na u përgjigj duke dhënë mendimin e tij se, në pritje të takimit me kryetarin e Qeverisë italiane, të procedohej në nënshkrimin e një marrëveshjeje për të gjitha nismat që kishin mbetur pezull gjatë kohës, si ato të natyrës ushtarë, ashtu edhe ato ekonomike. Ai ishte i sigurt që Parlamenti do ta miratonte atë marrëveshje, me kushtin që në atë të mos përmendej në asnjë pikë vendimi i ambasadorëve të vitit 1921.

Si përfundim i këtyre bisedave dhe në vijim të të dhënave të tjera, iu telegrafua Romës se Presidenti donte ta shihte kryetarin e Qeverisë italiane para se të firmosej një traktat në të cilin të mos përmbaheshin vendimet e 1921-shit, për të qenë brenda kundër çdo kundërveprimi të mundshëm politik në Shqipëri. Për të mënjanuar një mundësi si kjo e fundit, ai do të donte të ishte i njëmendimi edhe krëtari i Qeverisë italiane për një statut të ri që kishte ndërmend ta kalonte në Parlament. Ky statut do t'i jepte një autoritet më të madh dhe do të përgatiste kushtet për në fron.

Roma u përgjigj se, në rast të një pamundësie nga ana e Presidentit shqiptar për të firmosur një pakt të miqësisë, që të përmbante referime për vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, Legata ishte e autorizuar në përpilimin e një teksti në përputhje me propozimin tonë që ne ia kishim përcjellë ministrisë dhe që, pa e zënë me gojë atë rezolutë, kjo të përmendej tërthorazi. Kërkohej që, në çdo rast, marrëveshja të mos kishte asgjë të fshehtë; dhe, jo vetëm të kishte firmën e ministrit të Jashtëm, por edhe të ratifikohej në Parlament dhe pastaj t'i çohej Shoqërisë së Kombeve, për t'u regjistruar. Traktatit

duhej t'i bashkëngjitej edhe një konventë, edhe ajo publike, që të përmbante detyrimet hekurudhore, shkollore, financiare dhe ushtarake, për të cilat ishin në zhvillim negociatat.

Vijuan orë të vështira. Presidenti ngulte këmbë në pamundësinë në të cilën ndodhej për të firmosur një tekst që të përmbante një hedhje fjale (një aluzion), qoftë edhe si të mbuluar, për vendimet e 1921-shit para se të takonte, në shtator, kryetarin e Qeverisë italiane të cilin, sipas tij, ai do ta bindte që të hiqte dorë nga një kërkesë e tillë. Kështu traktativa dukej, tashmë, pa rrugëdalje. Për të na bindur sesa nuk kishte ndryshuar dëshira e tij për lidhje të ngushta me Italinë, pavarësisht nga vështirësitë e traktativave politike, Presidenti na sillte në kujtesë firmën që kishte vënë më 26 qershor qoftë për dekretin e koncesionit të naftës së Devollit që i jepej A.I.P.A.-s (Azienda Italiana Petroli Albania), qoftë për atë të rilevimeve topografike. Jepte fjalën se do të rregulloheshin menjëherë problemet financiare pezull, sipas kërkesave të këshilltarit delegat në Bankë dhe në S.V.E.A. Shpallte se ishte i gatshëm, madje, që ta firmoste marrëveshjen politike dhe ta bënte të njohur botërisht. Më 9 qershor legata jonë mori urdhrin e ministrisë së Jashtme që t'i shkohej, tashmë, në fund traktativave politike për paktin e miqësisë dhe të sigurisë. Në Romë mendoninin tani se fryma ndërkomëbetare ishte e volitshme që të përfundohej një pakt, i cili të ligjësonte para botës tërësinë e marrëdhënieve italo-shqiptare. Nuk pretej më që të kishte nga ana jugosllave kundërveprime të forta. Për çdo rast, do të duhej, megjithatë, që Qeveria shqiptare të vihej në kushtet për t'u bërë qëndresë kryengritjeve të mundshme që jugosllavët kishin nxitur në Shqipëri, - dhe do të vazhdonin ta bënin këtë edhe më pas -. Ministria, ndërkaq, ishte e gatshme për të përmbushur kërkesat shqiptare për armatim dhe për dërgimin e instruktorëve për dy divizione, kërkesë që lejohej nga gjendja që krijonte për Italinë deklarata e 1921-shit. Më 9 qershor legata jonë mori urdhrin e ministrisë së Jashtme që t'i shkohej, tashmë, në fund traktativave politike për paktin e miqësisë dhe të sigurisë. Në Romë mendoninin tani se fryma

ndërkombëtare ishte e volitshme që të përfundohej një pakt, i cili të ligjësonte para botës tërësinë e marrëdhënieve italo-shqiptare. Nuk pretej më që të kishte nga ana jugosllave kundërveprime të forta. Për çdo rast, do të duhej, megjithatë, që Qeveria shqiptare të vihej në kushtet për t'u bërë qëndresë kryengritjeve të mundshme që jugosllavët kishin nxitur në Shqipëri, - dhe do të vazhdonin ta bënin këtë edhe më pas -. Ministria, ndërkaq, ishte e gatshme për të përmbushur kërkesat shqiptare për armatim dhe për dërgimin e instruktorëve për dy divizione, kërkesë që lejohej nga gjendja që krijonte për Italinë deklarata e 1921-shit. Më 9 qershor legata jonë mori urdhrin e ministrisë së Jashtme që t'sllave. Edhe Franca nuk kishte mbetur jashtë kësaj loje. Këtë e tregonte salltaneti i ceremonisë në të cilën iu dha Presidentit të Republikës shqiptare kordoni i madh i Legjionit të nderit.

KREU II

TOKA E LAKMUAR

Traktativa për përfundimin e një pakti të miqësisë dhe të sigurisë që do t'i lejonte Italisë që të kishte te Shqipëria një Shtet të fortë dhe mik, përtej Adriatikut – Pengesat që shkaktoheshin nga delegacionet e Anglisë dhe të Jugosllavisë – Takimi në Livorno i Musolinit me Austin Çembërlenin – Zëvendësimi i ministrit të Anglisë në Durrës – Marrëdhënie të përzemërta me legatën angleze – Kryëngritja e malësorëve të Veriut të Shqipërisë – Firmosja e paktit të miqësisë dhe të sigurisë – Ankimet e legatës jugosllave – Ratifikimi parlamentar i paktit.

Tani gjithçka të çonte tek ajo se duhej vepruar në drejtimin që i kishte udhëzuar legata Romës, për të hequr dorë që të përmendej në traktatin e ardhshëm, cekja e deklaratës së 1921-shit. Megjithatë, ministria e Jashtme kishte ende shqetësimin, që e kishte nxitur edhe më tej qëndrimi që mbanin në Tiranë legatat angleze dhe franceze, se mos fuqitë e mëdha perëndimore mund të vërenin në këtë mungesë citimi (të 1921-shit.- p.) një nënvleftësim të Italisë të asaj deklarate, edhe nga ana e saj.

Sipas udhëzimeve që kishim marrë tanimë, më 7 korrik iu komunikua Presidentit të Republikës se nuk mund të flitej më për një pakt politik. Para se t'i hynim këtij argumenti, ishte e nevojshme të sqarohej atmosfera ndërmjet të dy vendeve, e përkeqësuar nga

ngjarjet e fundit. Presidenti na tha se ai duhet të ndërmerre një hap pranë ministrit anglez, sepse legata e Beogradit i kishte komunikuar se ishin bërë takime të ministrit italian me ministrin e Jashtëm jugosllav për mundësinë e një ujdije ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë për ndarjen e Shqipërisë, duke rrëzuar qeverinë e tij, pra të Ahmet Zogut, me ndërfitjen e bandave nga Jugosllavia. Këto lajme nuk i dukeshin edhe aq të sajvara, nëse me të vërtetë, siç i kishte thënë edhe vetë Aloizi, kryetari i Qeverisë italiane ishte zemëruar me atë, Zogun, për mospranimin e njohjes së asaj deklaratës që ishte vënë në diskutim gjatë bisedimeve. Kështu, këto tersllëqe e kishin bërë edhe atë që të merrte masat e tij. Por tha edhe se, pavarësisht nga këto, në bisedën me ministrin anglez kishte ritheksuar bindjen e tij, nëse kjo do të ishte e përputhshme edhe me vullnetin e palës tjetër, që të vazhdonte në politikën e tij të marrëdhënieve të ngushta me Italinë. Natyrisht që iu përgënjeshtroan lajmet që kishte dhënë Beogradi. Në të vërtetë asnjë bisedë nuk ishte bërë nga ana jonë me Jugosllavinë.

Mbase ishte një rrethanë e rastit, apo një vullnet për të ushtruar njëfarë trysnie, ardhja në Durrës, pikërisht në atë ditë, e kryqëzorit anglez "Dauntless". Ishte një sjellje e disa rretheve që nuk na shihnin me sy të mirë. Brenda anijes u bënë pritje dhe u organizuan mbrëmje vallëzimi. Këto patën vend edhe në legatën angleze. Ç'është e vërteta, qëndrimi ndaj nesh nga ana e funksionarëve dhe e oficerëve anglezë, që i një sjelljeje mjaft të zgjedhur (i një delikatese të rafinuar). Shpresat që u zgjuan në Qeverinë shqiptare nga prania e atij kryqëzori dhe nga qëndrimi që mbajti legata angleze në atë rast, dukeshin ashiqare, në vështirësitë gjithmonë e më të mëdha që hasnim tanimë në çdo argument në diskutim, qoftë edhe në ato të një rëndësie dytësore. Legata jonë bënte sikur nuk e vinte re këtë qëndrim të ri, duke mos dhënë, madje, fillimisht, asnjë sigurim, siç i ishte kërkuar, për traktatin e thjeshtë që të quhej gjithmonë se ishte ende në fuqi.

Roma u vu në dijeni dhe përgjigjja që pohuese. Nga një vizitë e deputetit Koçi dilte se në ditët e fundit Qeveria shqiptare ishte mjaft e shqetësuar nga mundësia që Italia, e zemëruar, do të mund

të pezullonte të gjitha ndihmat ekonomike. Ajo thënia se traktati i fshehtë ishte gjithmonë në fuqi, na dha njëfarë besimi, përderisa Këshilli i Ministrave tani kishte marrë në shqyrtim, në një mënyrë më pajtuese ndaj palës shqiptare, të gjitha çështjet ekonomike, të lëna pezull.

Meqë më 20 korrik legata kishte marrë nga Roma lajmin se po shvilloheshin shkëmbime mendimesh mbi përshtatjen e politikës së të dy vendeve ndaj Shqipërisë, te ne u krijua bindja se diçka ishte marrë vesh edhe nga Qeveria shqiptare dhe kjo krijoi një gjendje të re e më të mirë shpirtërore. Nga ç'na tha në mirëbesim një person me fuqi të madhe politike, Qeveria shqiptare ndodhej, në ato ditë, në kushtet e thesarit thuajse të zbrazët, kështu që ajo qeveri ishte në kërkim të një huaje, ngado që t'i vinte.

Më 15 gusht legata jonë u vu në dijeni në mënyrë zyrtare për bisedat që ishin zhvilluar në Londër ndërmjet Çembërlenit dhe ambasadorit Dela Toreta (Della Torretta), që kishin të bënin me lajmet e dërguara në Londër nga ministri anglez në Durrës. Ministri O'Reilly u thirr në Londër (Në të vërtetë ishte nisur disa ditë më parë.).

Më 10 shtator, me një lëvizje diplomatike të hijshme, Presidenti i Republikës u hapi udhën traktativave politike, duke i bërë të ditur baronit Aloizi se kishte ndërmend që të shkonte në Parisë, më 15 tetor, për një udhëtim që, ndonëse kishte karakter vetjak, do të merrte, sidoqoftë, edhe një pamje formale dhe protokollare. Gjatë bisedimeve ai na la të kuptonim sesa nuk do të donte që të ndërmernte atë udhëtim pa kaluar në Itali dhe, duke kaluar nga vendi ynë, nuk do t'i vinte mirë që të mos kishte edhe në vendin tonë takime si ato që do të kishte në Paris. (*)

(*) Diplomatët e karrierës do të mundën ta shpjegojnë më mirë, mendimin që mund t'i krijohet edhe lexuesit, për mënyrën kaq të mprehtë e të hijshme, sipas shprehjes së vetë autorit, për të kërkuar një takim me Musolinin. (Përkthyesi).

Përgjigjja nga Roma ishte që t'i bënim të ditur Zogut se përzemërsia e një takimi të tij në Romë me Musolinin do t'i

përgjigjej marrëdhënieve të përjetshme, që fati i kishte bërë të detyrueshme (fatale), të cilat i bashkonin të dy vendet, për arsye gjeografike dhe historike. Presidenti na u përgjigj, duke na u lutur t'i njoftonim kryetarit të Qerisë italiane se ai nuk do të shkonte në Paris, pa kaluar më parë në Romë dhe para takimit me Mbretin e Italisë dhe me kryetarin e Qeverisë italiane, ai do të përpiqej që t'i vinte në vijë, për kënaqësinë e Romës, të gjitha çështjet që kishin mbetur pezull.

Nëse me të vërtetë Presidenti donte në nisej me 15 tetor, nuk kishte përse të humbisnim asnjë minutë, sepse ishim bash në mesin e shtatorit. Iu paraqit Presidentit një projekt i traktatit, si ai që i ishte dhënë një muaj më parë, vetëm me heqjen e çfarëdo shenje që të kishte të bënte me deklaratat e 1921-shit. Presidenti na u përgjigj se ishte dakord, me përjashtim të ndonjë pike që kishte të bënte me formën. Në vijim të kësaj përgjigjeje, baroni Aloizi u nis për në Romë, më 17 shtator, për të përshtatur formalitetet e takimit që do të mundësonte përfundimin e negociatave politike.

Presidenti ishte në Durrës në vilën e tij që ngrihej përmbi legatën dhe pata me të biseda të pëlqyeshme. Kur donte, ai ishte një person me një nur e me një tërheqje të jashtëzakonshme. Ende i ri, meqë në vitin 1926 mund të ishte pak më tepër se 30 vjeç, i gjatë, me flokë të verdhë, i hollë, paraqiste tipare fizike që të bënin të mendoje për gjurmët e një gjaku gjerman, që ishin lënë ndër shekujt e largët nga Vizigotët në Shqipëri. Që në atë kohë ai kishte prapa tij një jetë politike prej jo më pak se dhjetë vitesh, që i kishte jetuar thellësisht, gjithmonë duke u gjendur në një plan të parë.

Traktativat kishin të bënin në atë çast thelbësor me Bankën e Shqipërisë dhe me S.V.E.A.-n, që vonoheshin për të hyrë në jetën e gjallë të vendit, sepse drejtuesit e këtyre institucioneve synonin veçanërisht në një organizim të përkryer të tyre, duke shmangur me sa të ishte e mundur, sajesa të atypëratyshme të rrezikshme. Kryeadministratori, profesor Amedeo Gambino, një person me aftësi të mëdha në botën financiare ndërkombëtare, nuk qëndronte në Shqipëri, por përfaqësohej atje nga njerëz shumë të aftë, ndër të cilët më kujtohet, duke e vlerësuar shumë, inxhinieri Bertè, si edhe

një inspektor i hekurudhave të Shtetit, inxhinier Sotili (për S.V.E.A.-n) dhe doktor Melisi, për Bankën e Shqipërisë.

Lajmi i takimit në Livorno të ministrit të Jashtëm anglez, Austin Çembërlenit, me kryetarin e qeverisë italiane, në ato çaste e ngriti humorin e miqve tanë shqiptarë. U bë e njohur tashmë, se ministri i Anglisë në Shqipëri, zoti O'Reilly, nuk do të kthehej më në Durrës. Një telegram i ministrisë njoftonte, veç të tjerave, se Lordi Tajrrëll, këshilltar i përhershëm në ministrinë e Jashtme angleze, i kishte thënë të ngarkuarit tonë për aferat në Londër se ngjarja e hidhur (aksidenti) i shkaktuar nga veprimi vetjak i përfaqësisë angleze në Durrës ishte, tashmë, përfundimisht i mbyllur.

Nëse jo të gjithë, së paku disa sektorë të konservatorizmit anglez, pranonin se ishte interesi i vendit të tyre që në Mesdhë të gjendej një Itali e zhvilluar, e qetë dhe e rregullt dhe se një veprim, si ai që po zhvillonim në Itali, në interesin tonë dhe në interesin e Shqipërisë, nuk mund të ishte veçse një përparim për qetësinë politike të pellgut (basenit) të Mesdheut, domethënë edhe për Anglinë.

Titullari i ri i legatës angleze, Sër Uilliam Seeds, që kishte ardhur para pak ditëve, qysh në vizitën e tij të paraqitjes, shprehu dëshirën për të mbajtur marrëdhëniet më miqësore si edhe gatishmërinë për shkëmbimin e lajmeve, sa më shpesh e me sinqeritet.

Në mendimin e Romës, marrëveshja politike do të duhej të parapërgatitej në Tiranë e pastaj të firmosej në Romë. Një veçori e njëfarë interesi psikologjik ishte që në mjediset më tradicionale të ministrisë së Jashtme italiane, dëshirohej që emri i traktatit të aleancës të saktësonte barazinë juridike të dy Shteteve kontraktuese dhe, për pasojë, konceptin e bashkëpunimit ndërkombëtar, për të gjitha ato të cilat, pranë paktit politik, shihnin edhe zhvillimet kulturorë dhe ekonomike të vendit.

Pati edhe mendime që në shprehjet e sigurisë shihnin si një nënkuptim për garanci, domethënë për një qëndrim epërsie nga ana jonë. Skema përmbante thelbësisht interesin e përbashkët për pavarësinë dhe për integritetin e Shqipërisë dhe detyrimin që asnjëra nga palët mos të bënte marrëveshje të tjera, në kundërtshtrim

me këto interesa të përbashkëta. Këto ishin koncepte për të cilat Qeveria dhe të gjithë shqiptarët nuk mund të mos ishin të njëmendjeje. Presidenti foli shkoqur. Ai, sidoqoftë, do të dëshironte që, sipas përvojës së mëparshme, asgjë të mos dilte në shesh për rifillimin e marrëveshjes, derisa kjo të bëhej e përsosur në çdo hollësi. Lajmi i udhëtimit të Presidentit u bë i njohur në mbrëmje, nga shtypi i vendit. Dhe të nesërmen u bë objekt për komente nga më të ndryshmet.

Ministri i Financave, Mufid bej Libohova, pohonte disa ditë më pas, përfundimin brenda një kohe sa më të shkurtër, të traktatit. Vizitat e eksponentëve më të mëdhenj shqiptarë, po bëheshin më të shpeshta. Mufid beu, duke ditur se edhe Mehmet Konica, njeri me përgatitje dhe me ndikim të madh, që kishte qenë ministri i parë i plotfuqishëm i Shqipërisë në Londër, kishte ardhur në legatë e më pyeti, si me shaka, nëse qëndrimi i tij si miku numër një i Italisë, mos ishte cënuar paksa nga Mehmet Konica. Me atë dhe me funksionarin e lartë të ministrisë së Jashtme shqiptare, Xhemil bej Dinon, që e njihte përsosurisht gjuhën italiane se kishte studiuar në Napoli, përgatitëm tekstin italian të projektit, që kishim marrë ndërkaq nga Qeveria shqiptare dhe që zhvillonte pikat e shënuara nga Roma. I telegrafuam menjëherë ministrisë sonë të Jashtme.

Koha po ecte, tanimë, me shpejtësi, por pikërisht në ato çaste Baroni Aloizi, që ishte kthyer në Tiranë, u mbërthye nga një sëmundje e rëndë e malaries. Më 7 nëntor erdhi nga ministria miratimi i tekstit të përpiluar nga Qeveria shqiptare, me redaktimin e disa redaktimeve të vogla. Presidenti i pranoi bocat. U shpreh, madje, se tani ishte i gatshëm ta firmoste menjëherë traktatin, që të do të miratohej sa më shpejt edhe nga Parlamenti. Na bëri edhe vërejtjen se ishte më vend që të përfundonim sa më shpejt përfundimin e traktativave, për shkak të lajmeve që vinin për përqendrime bandash në kufirin shqiptaro-jugosllav. Mund të shfaqej ndonjë rrezik për rendin puiblik, ndonëse i përkohshëm, që do ta detyronte t'i kushtonte të gjithë kohën e tij gjendjes së brendshme të vendit. Natyrisht ai nuk e hidhte më fjalën, tani, për atë mendimin e udhëtimit në Francë.

Me t'u vënë në dijeni ministri i Jashtëm, autorizoi veprimin e firmosjes së traktatit në Tiranë, por shtronte në të njëjtën kohë edhe një çështje tjetër: atë të firmosjes së njëkohshme të një konvente që të sanksiononte marrëveshjen ndërmjet të dy qeverive edhe për çështjet ekonomike. Disa nga këto ishin në fazën fillestare të marrëveshjeve. Iu përgjigjëm kësaj kërkesë, duke vënë në dukje se për konventën për çështjet ekonomike nuk ishte biseduar prej muajsh dhe, që të bëheshin bisedat për këtë tani për tani, kjo do të mund të merrej si një taktikë zvarritëse, po të kemi parasysh vështirësitë e brendshme për të cilat na kishte folur Presidenti.

Me Qeverinë shqiptare as që e zëmë në gojë kërkesën e re të Romës. Në një bisedë me Presidentin u bisedua edhe për dekorimet që do të bëheshin me rastin e firmosjes së paktit. Në kundërshtim me cektësinë e bisedave tona, mendime shumë më të rënda pushtonin shpirtat tanë. Unë e fshihja, në të vërtetë, ankthin me të cilin në legatë pritej përgjigjja e Romës në kërkesën tonë që të shkëputej, për t'u bërë më mvonë, firmosja e konventës ekonomike, duke i dhënë përparësi të menjëhershme firmës së marrëveshjes politike. Presidenti ishte i kursyer në dhënien e hollësive që ne na kishin rënë në vesh, për atë kryengitjen që ishte në shpërthim e sipër në malësitë katolike të Veriut të Shqipërisë, pikërisht në Dukagjin. Legata jonë, me arsyetimet që i bënte ministrisë sonë të Jashtëme, ishte e shqetësuar (për gjendjen e re shqiptare, p.) dhe do të dëshironte që të hiqeshin nga ata të Romës mendimet të cilat, të përligjura nga ata që nuk e njihnin atmosferën e ankthit në Tiranë, janë hequr nga koka e atyre të cilët, ndershëmrisht, e kuptojnë, - se e jetojnë ditë për ditë, - rrezikun e përfytyruar që po ravijëzohej. Shtyrja e firmës së marrëveshjes politike (për shkak të njëkohshmërinë me konventën, - p.) ka gjasa që ta rrëzojë ndërtesën, - në themel të së cilës ishte hë për hë firmosja pa zvarritje, - një ndërtesë, kjo, kaq e rëndësishme për të dy vendet. Presidenti, nga ana e tij, nuk mund të zgjatej në bisedat me legatën për gjendjen, ndoshta fare të përkohshme, të politikës së brendshme, gjendja e cila këshillonte përshpejtimin e përfundimit të marrëveshjes. Përndryshe do të zhvlerësohej rëndësia e saj dhe do të flashkeshin

arsyet e shëndosha dhe të qëndrueshme, që ishin të një vlere parësore.

Më së fundi erdhi nga Roma telegrami që shprehte qëndrimin mirëdashës kundrejt Presidentit dhe ndaj regjimit që ai kishte vendosur në Shqipëri. Si pasojë, nuk duhej të ngeceshim në gjera që duhet t'i kuptonim më gjerësisht. Telegrami nuk e përmendte as nga larg firmosjen e konventes ekonomike. Kjo donte të thoshte se mund të procedohej në përfundimin e paktit politik. Kështu e quajta si detyrë që të vija te Presidenti dhe ta njoftoja për përmbajtjen e telegramit. E pikërisht aty mora vesh nga ai, që m'u duk mjaft i kthjellët, për kryengitjen që kishte shpërthyer në Dukagjin më 20 nëntor.

Të dhënat që kishim nga konsullata jonë në Shkodër e bënë si të afërt rënien e Shkodrës në duart e kryengritësve, nëse nuk do të vinin sa më shpejt përforcime nga Tirana. Këto nuk mund të vinin në ndihmë veçse nga grupe të armatosura të Matit ose të Dibrës; ishin trupa që kisha takuar në rrugëkryqin e Vorës për në Shkodër, gjatë udhëtimit tim nga Durrësi për në Tiranë, po në atë ditë.

Gjendja në Shkodër po përmirësohej. Këtë ma tha vetë Presidenti i Republikës. Nuk u tregua i padurueshëm për këtë firmë. Ishte e qartë se nuk donte të jepte përshtypjen se kryengitja e malësorëve e bënte të ngutshme këtë firmë. Gjatë ditës, konsullata e Shkodrës na vuri në dijeni së kryengritësit ishin, tashmë, krejtësisht të rrethuar. Puka, qendra e hershme e nxjerrjes së bakrit, - që në kohë të romakëve-, binte herë në dorë të kryengritësve, herë në dorë të qeverisë, për të mbetur, së fundi, në dorë të kësaj të fundit. Ministri anglez, gjatë një vizite në legatë, na i saktësoi këto lajme të mira. Ai kishte ardhur, sidomos, për të kërkuar të dhëna për mbërritjen në Durrës të kryqëzorit që kishte sjellë në Shqipëri sekretarin e dytë, Paolo Korteze, i cili kishte ardhur vullnetarisht, sapo mori vesh për gjendjen e krijuar nga kryengritja, ndonëse ishte me pushime. Gjatë të gjithë ditës, më 25, kishte një denduri vizitash diplomatike që donin të merrnin vesh për gjendjen e krijuar në veri. Legata italiane ishte, tashmë, në qendër të jetës së vendit. Deputeti Koçi erdhi të na njoftonte se firma ishte vendosur për të

nesërmen, në orën 11. Pastaj ajo u shty për në oran 18.

Por një ngjarje e re u përvijua ndërkaq: një telegram nga Roma na lajmëronte se, në vijim të lajmeve që kryqëzorë anglezë do të vinin në Durrës, me rastin e festës kombëtare të 28 nëntorit, Roma do të dërgonte edhe ajo, në të njëjtën ditë, dy kryqëzorë dhe katër torpedinierë. Me opaninë e anijeve tona të luftës në Durrës, firmosja duhej shtyrë, natyrisht, për të mos dhënë përshtypjen se ajo po bëhej nën kërcënim. Për fat të mirë, të nesërmen u mor vesh se, meqë ishte shtyrë dita e anijeve të kryqëzorëve anglezë, ishte pezulluar edhe dërgesa e skuadrës sonë detare. Po atë mbrëmje, deputeti Koçi na lajmëroi se firmosja ishte shtyrë edhe për një ditë. Na tha se në Këshillin e Ministrave u vunë re disa paqartësi të vogla në disa caqe (terma) të traktatit. Por lutja që na kishte bërë ministri i plotfuqishëm Xhemil Dino, bëri që anijet italiane të vonoheshin dhe kështu do të mund të ndodhte që mbërritja e anijeve italiane të vinte bash në kohën e firmosjes së traktatit.

Kështu, më 27 nëntor, një ditë më parë nga festa kombëtare shqiptare, në orën 20, pakti i miqësisë dhe i sigurisë ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë u firmos nga baroni Aloizi dhe nga ministri i Punëve të Jashtme, Hysen bej Vrioni. Vështirësia e vetme, që doli në ditën e fundit, ishte se teksti duhej përpiluar në të dyja gjuhët, për çdo rast e interpretimesh të ndryshme, për t'u saktësuar këto në të dy tekstet.

Duke i komunikuar Qeverisë italiane këtë firmosje, legata theksonte bindjen e Tiranës që, qysh nga ai çast, për Shqipërinë hapej një fazë e re e politikës së jashtme, që tani frymëzohej nga një bashkëpunim i besueshëm me Italinë.

Më 28 nëntor, me rastin e pritjes së trupit diplomatik nga ana e Presidentit të Republikës, patëm përshtypjen e parë se lajmi i firmës së traktatit kishte kapërcyer muret e fshehtësisë dhe po trupëzohej kundërveprimi jugosllav. Vetë Presidenti i Republikës komunikoi, më 30 nëntor, se kishte pritur një ditë më parë ministrin e Jugosllavisë, tërë ankth për të marrë njoftime, dhe e kishte vënë atë në dijeni për vijat e përgjithshme të traktatit. Ai e quante të përshtatshme që të botohej sa më shpejt një komunikatë në të cilën,

pa e riprodhuar tekstin tërësor të paktit, të përmbledheshin pikat kryesore të tij. Po në atë mbrëmje, ministri i Jashtëm na pruri në legatë tekstin e projektit të komunikatës. Nga ky tekst dilte mendimi, doemos për t'u pëlqyer mjediseve jugosllave, se Shqipëria ishte e gatshme për të firmosur traktate të tilla edhe me vendc të tjera.

Teksti i komunikatës iu telegrafua menjëherë Romës nga ana jonë. Të nesërmen, më 1 dhjetor, morëm si përgjigje se ky tekst do të botohej në Itali, në oran 16. Në mëngjes, në përshtatje me shkëmbimin e informatave, iu bë e njohur ministrit anglez teksti i traktatit. Në mbrëmje, në një darkë të shtruar në legatën rumune, në të cilën, për shkak të qëndrimeve tona të gjata në Bukuresht, të baronit Aloizit dhe të miat, gëzonim simpatinë e rumunëve, ministri Trandafiresko na tha, për të na qetësuar, se kishte mbajtur një qëndrim zbutës pranë ministrit jugosllav, i cili iu duk i turbulluar dhe i shqetësuar.

Më datën 4 (dhjetor) i ngarkuari me punë i B. Sovjetik bëri një hap zyrtar pranë qeverisë shqiptare. Ndihej në ajr përshtypja se ai po i frynte në Tiranë një fushatë kundër paktit. Legata e këshilloi Romën që të botonte një notë shpjeguese, që t'u binte me sëpatë të gjitha interpretimeve keqdashëse në lidhje me këtë çështje. Me të ardhur miratimi i Qeverisë italiane, projekti i notës iu bë i njohur Qeverisë shqiptare. Por edhe kundër kësaj note protestuan ministri i Jugosllavisë dhe i ngarkuari me punë i Greqisë. Ata të dy u orvatën, madje, ta kërcënonin ministrin e Jashtëm, Hysen Vrionin. Në dobi (në favor) të botimit të notës ndërhyri Iliaz Vrioni, kushëriri i Hysenit, ish-ministër në Paris, me ndikim të madh në të gjitha mjediset shqiptare.

Më 8 dhjetor, teksti i traktatit iu paraqit Dhomës së deputetëve. Leximi u prit me duartrokitje të njëzëshme. U vendos që teksti t'i paraqitej për shqyrtim komisionit të Jashtëm. E vetmja dëshirë që u shpreh nga ky Komision ishte që letra shpjeguese e ministrit të Italisë t'i bashkëngjitej relacionit të Komisionit. Të nesërmen në mëngjes Dhoma e deputetëve e miratoi njëzëri tekstin e traktatit të miqësisë dhe të sigurisë italo-shqiptare Shumë fjalime ngazëlluese

dhe duartrokitje të hareshme, në drejtim të Italisë.

Vazhdoi një hap i ri zyrtar pranë Qeverisë shqiptare, nga i ngarkuari me punë jugosllav, zoti Kolombatoviç. Por ai, tanimë, nuk mund të ndalte rrjedhën e ngjarjeve. Në pasditën e së nesërme, edhe Senati shqiptar e miratoi njëzëri traktatin. Roma telegrafoi se nota shpjeguese do t'i paraqitej Shoqërisë së Kombeve, bashkë me tekstin e traktatit.

Përfundimi i traktatit u kishte kushtuar shumë punë dhe mjaft durim funksionarëve të ministrisë sonë të Jashtme, qoftë në Tiranë, qoftë në Romë, ku meritën e kishte veçanërisht, ministri i atëhershëm i plotfuqishëm Vinçenco Lo Jakono (*). Veprimi ynë diplomatik u udhëhoq duke ruajtur vijat thelbësore të problemit, dobia e të cilit u ndje instinktivisht nga pjesa më e madhe e shqiptarëve, ndonëse nuk i njihje vështirësitë e brendshme qoftë të anës sonë, qoftë të Qeverisë shqiptare. Duke përjashtuar pengesat nga disa persona, për arsye të tyre të veçanta, vështirësitë më të shumta vinin nga shpërthimet e nacionalizmit i cili, në atë kohë, kudo në Europë, u nginte mendjen njerëzve. Në Itali ai ishte ende i frenuar nga një traditë e shëndoshë, si edhe nga matura e funksionarëve të rritur në këtë traditë. Në Shqipëri, një dashuri e pamasë për tokën shqiptare i çonte të rinjtë, veçanërisht ata që kishin studiuar dhe jetuar për një kohë të gjatë në Francë, në Angli dhe në Itali që ta shihnin Shtetin si diçka të ngjashëm, në çdo pikëpamje, me fuqitë e mëdha të Perëndimit. Me dashje ata i mbyllnin sytë (për të parë qartësisht, -p.) - nën magjepsjen e një barazimi formal, - realitetin e fakteve që e mbanin Shqipërinë ende larg arritjes së një barazie thelbësore (substanciale).

(*) Aleksandër Lesona (Lessona) i del për zot vertvetes, në librin e tij të *Kujtimeve* (1958), duke u treguar i pezmatuar ndaj nënvleftësimit që i bëhet personit të tij nga Jakomoni, për ndihmesën e madhe, në hapjen fillestare të bisedimeve me Presidentin shqiptar, për traktatin e marrëveshjes që përshkruhet në këtë libër. Në të vërtetë Jakomoni e përmend mjaft herë emrin e Lesonës, por nuk e rendit atë në rolin kryesor të meritave për paktin (p.)

Në këtë barazi thelbësore, siç thoshnin ata, Shqipëria nuk kishte mbërritur, jo për vogëlsinë e truallit të saj apo për popullsinë e pakët, por vetëm sepse nuk kishte mundur dot të merrte pjesë, gjatë pesë shekujve të pushtimit otoman, në lëvizjen e thellë shpirtërore që ishte e mundshme për vendet e Europës perëndimore. Nacionalistët më të moderuar shikonin tek Italia të vetmin vend perëndimor që ishte i interesuar për të ruajtur njësinë, pavarësinë dhe integritetin etnik të Shqipërisë. Simboli i kësaj së vërtetë ishte, për shumë shqiptarë, Gjergj Kastrioti Skenderbeu, gjiganti i historisë së tyre, heroi i mbrojtjes së fundit të civilizimit të krishterë në Ballkan. Figura e tij e qytetarit, e atdhetarit dhe, më pas, e kreytarit të lidhjes së princërve shqiptarë, ishte e pandashme nga ajo e senatorit venedikas dhe nga ajo e princit napoletan.

Për Shqipërinë, programi u përgjigjej idealeve të miqësisë dhe të bashkëpunimit me Italinë, për të cilën Gjergj Kastrioti ishte bërë Kalorës (paladin – kalorës i Karlit të Madh), katër shekuj më parë. Më 31 tetor 1460 ai i shkruante mbretit të Napolit, Ferdinandit të Aragonës, për t'i kujtuar se, kur Shqipëria gjendej nën kërcënimin më të madh otoman, ai i ishte drejtuar atij për ndihmë. Gjergj Kastrioti ishte i dëshpëruar tani, që Ferdinandi ishte në rrezik të madh që të humbiste mbretërinë, e nuk iu drejtua mikut shqiptar për ndihmë. I shkruante se, edhe pa e kërkuar këtë ndihmë, ai do ta kapërcente vetë detin, bashkë më njerëzit të cilët tani i mungojnë, "e do të më mjaftonte shpirti për t'i plotësuar luftëtarët, me të mijtë, për t'i shërbyer Madhërisë Suaj".

Nga ana tjetër, nëse për Italinë ishte e dobishme për vetë sigurinë e saj, që trualli shqiptar, 70 km larg brigjeve të veta, t'i përkiste një Shteti të fortë dhe mik, ishte edhe e natyrshme që ky vend të forcohej, të përparonte, të ishte në gjendje të jetonte e të përparonte.

Për të dy qeveritë ishte një program i gjerë për veprim të përbashkët që ravijëzohej me një pakt të miqësisë dhe të sigurisë, në vitin 1926. Programi ishte i përputhshëm për shtetin italian me konceptet që e kishin paraprirë qysh me lindjen e tij. Në mendimin e krijuesve të këtij shteti ky u ngrit për të ushtruar një veprim

barazpeshë ndërkombëtare në një përtëritje të përgjithshme shoqërore europiane, mbi themele kombëtare. Paskuale Stanislao Mançini, që kishte përgatitur normat e reja të kësaj bashkëjetese, kishte lënë, si ministër i Jashtëm, një gjurmë të shënuar në administratën që kishte drejtuar. Ai i kishte mësuar ata që e dëgjonin, që të pajtonte atë që Xhoberti e quante "aftësia e veçante e çdo vendi", me atë që kanë të përbashkët të gjitha kombet, e që ka të bëjë me të drejtën e pavarësisë kombëtare, me detyrën e përbashkët për të respektuar atë të të tjerëve. Në traditën rilindëse të administratës së ministrisë së Jashtme, politika italiane duhej të ishte jo nacionaliste, por në një shkallë të lartë kombëtare.

Fazat nëpër të cilat kaloi nënshkrimi i paktit të miqësisë dhe të sigurisë të dëshmonin një për një, megjithatë, se zbatimi praktik i programit nuk ishte i shkëputur nga vështirësitë. Unë vetë nuk munda për një kohë të gjatë të ndiqja nga afër ngjarjet e njëpasnjëshme, sepse e lashë Tiranën pas pak kohe nga përfundimi i paktit. Nuk u ktheva, vetëm se për një qëndrim të shkurtër në vitin 1929, në shoqërimin që i bëra ministrit të Jashtëm, Dino Grandit, me rastin e një vizite të tij zyrtare mbretit Zog, vetëm dhjetë vite më vonë: në vitin 1936.